

Përmbajtja

1. Fjala përshëndetëse e Drejtorit të përgjithshëm	3
2. Bordi Menaxhues	4
3. Këshilli Drejtues	5
4. Struktura organizative e Bankës Ekonomike	6
5. Vizioni dhe Misioni	7
6. Vështrim i përgjithshëm i ekonomisë kosovare	9
6.1 Produkti i brendshëm bruto (GDP)	10
6.2 Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet	11
6.3 Inflacioni	12
6.4 Tregtia e jashtme	12
6.5 Bujqësia	13
6.6 Papunësia	14
6.7 Sistemi bankar	15
7. Vështrim mbi afarizimin e Bankës Ekonomike	19
7.1 Numri i llogarive të klenëve	20
7.2 Kreditimi	21
7.3 Depozitat	22
7.4 Thesari	23
7.5 Qarkullimi i pagesave	24
7.6 Menaxhimi i riskut kreditor	26
7.7 Burimet njerëzore	28
7.8 Marketingu	29
8. Raporti i auditorëve të pavarur	32
9. Pasqyrat financiare	38
10. Adresat dhe kontaktet	68



1.Fjala përshëndetëse e Drejtorit të përgjithshëm

Edhe viti 2010 ishte vit mjaft i vështirë i afarizmit të institucioneve financiare në Kosovë si dhe në mbarë botën. Kriza financiare globale la pasojë mjaft të mëdha në ekonominë e vendit, ku shumë biznese kanë hasur në vështirësi të mëdha. Fuqia blerëse ka rënë dukshëm, gjë që ka ndikuar në rënien e shumë kompanive me renome.

Sistemi bankar i Kosovës, pjesë e së cilit jemi edhe ne, përkundër vështirësive që ka pasur, ka qëndruar mjaft stabil,.

Banka Ekonomike mbylli këtë vit me rritje të konsiderueshme të asetëve, por me afarizëm negativ. Gjithashtu, kemi pasur edhe rritje të pjesëmarrjes në treg dhe, në fund të vitit 2010, kjo rritje ka arritur në 5.5%.

Rezultati negativ në një shumë prej 612.501 EUR, ka rrjedhur kryesisht nga rezerva e ndarë për kreditë e këqija dhe vetëm gjatë vitit 2010 kemi ndarë rezervë shtesë rreth 3.056.285 EUR, gjithashtu edhe nga investimet e mëdha që janë bërë me zgjerimin e rrjetit të degëve si dhe me lansimin e produkteve të reja.

Në fokus kryesor në vitin 2010 Banka e ka pasur trajnimin e të punësuarve në fusha të ndryshme - në veçanti në shitje dhe komunikim me klientët, në mënyrë që t'u ofrojmë kushte dhe shërbime sa më të mira.

Banka Ekonomike është duke vazhduar me zgjerimin e rrjetit të saj në gjithë territorin e Kosovës duke krijuar një imazh pozitiv në sektorin bankar.

Gjatë vitit 2010, dega kryesore ekzistuese në Pejë është vendosur në objekt të ri dhe janë hapur gjashtë nëndegë të reja në Gjilan, Suharekë, Pejë, Skënderaj, Viti e Deçan dhe janë rinovuar 4 nëndegë ekzistuese, dy prej tyre në Rahovec, një në Junik dhe një në "Nëna Tereze" në Prishtinë. Po ashtu janë hapur dy sportele në Prizren, një në Vërmicë dhe tjetri në ndërtesa e Komunës .

Të gjitha këto objekte janë sipas standardeve të reja bashkëkohore dhe krijimi i këtyre hapësirave në përputhshmëri me standardet e reja i bën zyrat tona më të përshtatshme dhe më të efektshme për kryerjen e shërbimeve të klientëve. Në fund të vitit 2010, rrjeti i përgjithshëm i Bankës Ekonomike arrin në 44 degë, nëndegë dhe sportele.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar lansimit të kartelave ndërkombëtare VISA dhe MASTER ku, pas një angazhimi shumë të madh, kemi arritur t'i lansojmë me sukses këto produkte.

Shkak i rritjes së vazhdueshme të numrit të klientëve është edhe fokusimi ynë në zgjerimin e rrjetit të ATM-ve (bankomatëve) me qëllim që klientëve t'u kursejmë kohën për kryerjen e shërbimeve bankare dhe ata mund të kenë qasje në llogaritë / paratë / e tyre 24 orë në ditë . Gjatë vitit 2010 janë vendosur 11 ATM të rinj në qytete të ndryshme të Kosovës. Numri i ATM-ve (bankomatëve) në rrjetin tonë tani ka arritur në 32.

Gjatë këtij viti, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës që të shpërndahet dividenda e PTK'së, njërit ndër depozituesit më të mëdhenj në Bankën tonë, ishim të detyruar që të transferojmë në llogarinë e Thesarit në MEF shumë prej 15.4 milionë EUR, shumë kjo e cila ishte brengë kryesore për menaxhmentin e Bankës sonë. Falë fushatave të suksesshme për kursime dhe angazhimit maksimal të gjithë stafit këto depozita, përveç që u zëvendësuan, edhe u rritën për 31.7 % - në pjesën më të madhe nga depozitat e qytetarëve, respektivisht të personave fizikë.


Departamenti i Teknologjisë Informative ka bërë një punë të shkëlqyer me automatizimin e sistemit të Bankës, veçanërisht të modulit kreditor, mandej me avancimin e Sistemit Informativ të Menaxhmentit, me krijimin e e-bankingut ndër më të mirët në sistemin bankar, me avancimin e SMS banking e shumë moduleve të tjera të cilët e kanë lehtësuar punën dhe kanë përbushur shumë kërkesa të Bankës Qendrore.

Gjatë vitit 2010, Bankës Ekonomike i është ndarë nga Ministria për Tregti e Industri dhe Agjencia për mbështetjen e NMV-ve çmimi banka më e suksesshme në sektorin e shërbimeve.

Në fund, dua të cek se Banka Ekonomike, me rritjen e asetëve të saj dhe me të gjitha këto që u thanë më lart, ka një bazë të fortë, e cila do të garantojë afarizëm të suksesshëm në vitet në vijim.

Dua të falënderoj gjithë stafin e Bankës për përkushtimin e lartë në punë, aksionarët e Bankës Ekonomike dhe sidomos Këshillin Drejtues nga të cilët kemi pasur përkrahje maksimale.

Ju faleminderit!



Valon Lluka
Drejtor i përgjithshëm



2. Bordi Menaxhues



Valon LLUKA
Drejtor i përgjithshëm
Chief Executive Officer

Fisnik KËPUSKA
Zëvendësdrejtor i përgjithshëm
Deputy CEO

3. Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues i Bankës Ekonomike ka këtë përbërje:

Afrim PACOLLI
Kryetar

Raif REXHEPI
Zëvendëskryetar

Hasan HAJDARI
Anëtar


Xhabir KAJTAZI
Anëtar

Selim PACOLLI
Anëtar

Qerim RAMADANI
Anëtar

Valon LLUKA
Anëtar
Drejtor i përgjithshëm

4. Struktura organizative e Bankës Ekonomike



5.Vizioni dhe Misioni

Banka Ekonomike do të jetë bankë transparente, e hapur, e orientuar në sigurimin e shërbimeve cilësore për klientët duke ofruar standarde të larta profesionale.

Misioni ynë do të jetë: të jemi ofrues vendas modernë të shërbimeve bankare e financiare, duke ofruar cilësi e vlerë, nëpërmjet operimit me teknologji të avancuara moderne, kapacitete të larta menaxheriale e performansë të lartë në përmbushjen maksimale të nevojave të klientëve tanë.

Në funksion të arritjes së misionit tonë, ne synojmë të sigurojmë një përdorim racional të burimeve tona të brendshme, si ato teknologjike ashtu edhe ato njerëzore.

Grupi i klientëve tanë, përbëhet si nga individë të cilët besojnë në kursimet e tyre dhe i përmbushin nevojat individuale, ashtu edhe nga kompani biznesi. Klientët e biznesit janë kryesisht kompani të suksesshme të vogla e të mesme, por edhe të mëdha, të cilat kanë nevojë për rritje të mëtejshme.





6. Vështrim i përgjithshëm i ekonomisë kosovare

6. Vështrim i përgjithshëm i ekonomisë kosovare

Deri në fillim të vitit 2010, sidomos në pesë-gjashtë vitet e para pas përfundimit të luftës (qershor 1999), ekonomia kosovare karakterizohet me fazën e rindërtimit të vendit të shkatërruar gjatë luftës: shtëpive e objekteve të banimit, ambulancave e shkollave të rrënuara e të djegura, rrugëve dhe urave të rrënuara e të dëmtuara, me zhvillimin e sektorit privat të ekonomisë dhe jashtë ekonomisë, me krijimin e sistemit bankar me Bankën Qendrore të Kosovës dhe 7 banka komerciale, me fillimin e procesit të privatizimit me intensitet të shtuar në tre vjetët e fundit, me investime në sektorin e energjetikës, kryesisht nga donacionet e bashkësisë ndërkombëtare, që rezultoi me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik, etj.

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, në bazë të rritjes së ulët të produktit të brendshëm bruto (GDP) për kokë banori ndikoi në rritjen e vazhdueshme të papunësisë dhe moszgjidhjen e statusit të pensionistëve. Edhe në vitin 2010 nuk ka pasur lëvizje të ndjeshme të zhvillimit ekonomik. Prodhimi i brendshëm bruto për kokë banori ishte ndër më të ultët në rajon. Është me rëndësi të ceket se mbi 93% e gjithsej punëkërkuessve janë të papunë për një periudhë më të gjatë se 12 muaj. Mbulesa e importit të mallrave dhe të shërbimeve me eksport në fund të vitit 2010 ishte e ulët (13.71 %), për shkak të varësisë së ekonomisë kosovare nga importet, që tregon nivelin e ulët të zhvillimit global dhe struktural të ekonomisë.

6.1 Produkti i brendshëm bruto (GDP)

Niveli i ulët i Produktit të brendshëm bruto (GDP) për kokë banori është tregues i nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik të Kosovës pas luftës së vitit 1999 e deri në fund të vitit 2010 dhe, krahasuar me vendet e rajonit, Kosova është vendi më i pazhvilluar. Niveli i produktit të brendshëm bruto për kokë banori në periudhën pesëvjeçare 2002-2007, ishte më i larti në vitin 2002 (1.288 EUR) ndërsa në fund të kuartalit të tretë të vitit 2010 është realizuar në shumën prej 1.766 EUR ose 2,02 % më i lartë se në vitin paraprak. Realizimi i Produktit të brendshëm bruto në Kosovë në këtë nivel është rrjedhim i disa faktorëve kryesorë, e sidomos i mungesës së prodhimit vendor, investimeve të huaja, mospërfundimit të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore e mosaktivizimit të shumë ndërmarrjeve të privatizuara, rënies drastike të donacioneve të bashkësisë ndërkombëtare. Në formimin e Produktit të brendshëm bruto më së shumti kanë ndikuar tre faktorë: importet, asistenca e huaj dhe dërgimi i mjeteve:

Produkti i brendshëm bruto ¹

PËRSHKRIMI / PERIUDHA	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
GDP (në mil. euro)	2.447	2.420	2.282	2.238	2.270	2.378	3.804	3.792	3.868
GDP për banor (në euro)	1.288	1.252	1.161	1.120	1.117	1.150	1.759	1.731	1.766
Dërgesat e punëtorëve (në mil.euro)	341	341	215	281	318	398	536	506	506
Ndihma nga jashtë (në mil.euro)	887	688	565	491	465	352	357	291	274
Popullsia (në 000)	1.900	1.932	1.965	1.999	2.015	2.063	2.096	2.129	2.162

¹Banka Qendrore e Republikës së Kosovës: "Monthly Statistics Buletins" dhjetor/10

6.2 Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore në fund të vitit 2010 janë realizuar në shumën prej 1,224.9 milionë EUR. Niveli i të ardhurave të përgjithshme buxhetore varet nga niveli i zhvillimit ekonomik të vendit. Të ardhurat e përgjithshme buxhetore, që nga viti 2003 janë realizuar kryesisht nga të hyrat vendore: dogana, TVSH, tatimi i paraparë, tatimi në të ardhurat e korporatave dhe taksat e tjera. Në strukturën e të ardhurave buxhetore, të ardhurat nga dogana marrin pjesë me 57.01 % në fund të vitit 2010 dhe janë më të larta se në të njëjtën periudhë të vitit paraprak për 88.2 mil. EUR, për shkak të importit të lartë. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore në fund të vitit 2010 janë realizuar në shumën prej 1,282.49 mil. EUR, përkatësisht më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar për 143.89 mil. EUR.

Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet ²

PËRSHKRIMI / PERIUDHA	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Të ardhurat e përgjithshme buxhetore nga taksat:	444.4	536.4	550.1	559.6	621.1	712.3	804.5	807.0	886.2
- doganat	364.5	428.3	436.0	436.5	457.1	531.8	604.2	633.9	698.4
-taksa e tjera	79.9	108.1	114.1	123.1	164.0	180.5	200.3	173.1	189.2
Të ardhurat e tjera	91.3	93.9	84.7	81.9	92.1	184.1	137.1	329.7	331.8
Gjithsej:	537.7	630.3	634.8	641.5	713.2	896.4	941.6	1,136.7	1,224.9
Shpenzimet e përgjithshme	428.6	567.7	769.4	702.4	635.7	662.7	943.8	1,138.6	1,282.5

²Banka Qendrore e Republikës së Kosovës: "Monthly Statistics Buletins" dhjetor/10

6.3 Inflacioni

Inflacioni, përmes çmimeve me pakicë, ka shënuar rritje të ulët, nga viti 2002, kur ka filluar të llogaritet inflacioni pas luftës së vitit 1999. Rritja më e lartë është shënuar në fund të vitit 2003 për 3,7% , ndërsa në fund të vitit 2005 është shënuar rritja prej 2,8% , në fund të vitit 2006 për 3.9% , në fund të vitit 2007 për 10,4% , në fund të vitit 2008 për 10,9% , në fund të vitit 2009 për 11,0%³, dhe në fund të vitit 2010 për 18,3%³

Rritja e inflacionit ishte më tepër rezultat i inflacionit të importuar, për shkak të importit shumë të lartë të mallrave dhe të shërbimeve.

6.4 Tregtia e jashtme

Gjatë vitit 2010 kanë vazhduar aktivitetet më të mëdha në import se në eksport të mallrave dhe të shërbimeve.⁴ Shuma e përgjithshme e importit prej 2.144.9 mil. EUR në fund të vitit 2010 ishte më e lartë se në fund të vitit 2009 për 246.2 mil. EUR, ose për 12.97%. Ndërsa, shuma e përgjithshme e eksportit në fund të vitit 2010, prej 294.0 mil. euro ishte më e lartë se në fund të vitit 2009 për 131.4 mil. EUR, ose për 80.8%. Për shkak të rritjes së eksportit në fund të vitit 2010, është rritur edhe mbulesa e importit me eksport nga 4,1% në fund të vitit 2005 në 6,0% në fund të vitit 2006, në fund të vitit 2007 në 9.3%, në fund të vitit 2008 në 10.16%, në fund të vitit 2009 në 8,56%, dhe në fund të vitit 2010 në 13,71% ndërsa deficitin e bilancit tregtar nga 1.131,1 mil. EUR në 1.235,3 mil. EUR në 2006, ndërsa në 1.429 mil. EUR në fund të vitit 2007, në 1.732 mil. EUR në fund të vitit 2008, në 1.736,1 mil. EUR në fund të vitit 2009, dhe në 1.850,90 mil. EUR në fund të vitit 2010 .

PARTNERËT KRYESORË TREGTARË TË IMPORTIT NË FUND TË VITIT 2010 ME 76,31% PJESËMARRJE, JANË:

Unioni Europian	38,29%
Maqedonia	14,74%
Serbia	12,13%
Turqia	6,97%
Shqipëria	3,22%
Zvicra	0,96%

³Banka Qendrore e Republikës së Kosovës: "Monthly Statistics Buletins" dhjetor/10

⁴Banka Qendrore e Republikës së Kosovës: "Monthly Statistics Buletins" dhjetor/10

PARTNERËT KRYESORË TREGTARË TË EKSPORTIT ME 75,14%
PJESËMARRJE JANË:

Unioni European	44,73%
Shqipëria	10,99%
Maqedonia	8,95%
Zvicra	6,02%
Turqia	3,16%
Serbia	1,29%

6.5 Bujqësia

Toka bujqësore përfshin 53% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës së Kosovës. Shumica e tokës bujqësore është në pronësi private (80%), për të siguruar ekzistencën për familjet. Megjithëse sektori i bujqësisë në përgjithësi karakterizohet me ferma të vogla, produktivitet të ulët dhe mungesë të shërbimeve këshillëdhënëse, bujqësia kontribuon me rreth 25% të bruto produktit të brendshëm (GDP) të përgjithshëm të Kosovës. Bujqësia është sektori më i madh në Kosovë, që krijon vende pune, duke u siguruar punë rreth 25% deri 30% të popullatës, kryesisht në baza joformale. Sektori i bujqësisë gjithashtu siguron 16% të vlerës së eksportit të përgjithshëm dhe mbetet kreator i rëndësishëm i pasurisë kombëtare, megjithëse Kosova ende importon shumë produkte bujqësore dhe mbulon vetëm 24% të të gjitha importeve.

6.6 Papunësia

Papunësia është në rritje të vazhdueshme që nga viti 2000, kur evidentohen 208.074 të papunë, ndërkohë që ky numër, në fund të vitit 2007, ka arritur në 334.595, do të thotë 60,8% më shumë; në fund të vitit 2008 në 335.942; në fund të vitit 2009 në 337.842 dhe në fund të vitit 2010 në 335.260.

Në rritjen e papunësisë ka ndikuar niveli i ulët i zhvillimit ekonomik.

PERIUDHA	Numri i të papunëve	Femra %	Edukim elementar %	Edukim sekondar %	Edukim universitar %
2002	257.505	44,5	61,5	36,2	2,2
2003	282.305	45,4	63,0	35,3	1,7
2004	301.982	45,7	63,4	35,1	1,5
2005	319.721	46,3	63,5	35,0	1,5
2006	326.026	46,7	63,7	34,8	1,5
2007	334.595	46,8	63,9	34,7	1,5
2008	335.942	47,1	63,9	34,6	1,5
2009	337.842	47,6	64,0	34,4	1,5
2010	335.260	50,8	63,6	34,7	7,6

Pjesëmarrja e femrave në numrin e përgjithshëm të papunësuarve është rritur nga 44,5% në vitin 2002 në 47,1 % në fund të vitit 2008, në 47,6% në fund të vitit 2009 dhe në 50,8% në fund të vitit 2010. Ndërsa, sipas kualifikimit shkollor, në fund të vitit 2010 pjesëmarrje më të lartë ka shënuar edukimi elementar me 63,6% dhe më të ulët edukimi universitar me 7,6%.

6.7 Sistemi bankar dhe financat

Sistemi bankar i Kosovës përbëhet prej 7 bankave komerciale të nivelit të dytë dhe 311 degëve e nëndegëve⁵ në tërë territorin e Kosovës. Të gjitha bankat komerciale selinë e kanë në Prishtinë, ndërsa degët e tyre gjenden në shtatë qendra kryesore të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjiilan, Ferizaj.

Bankat, me degët dhe nëndegët e veta, janë të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në mbështetje të Rregullores për Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankave të vitit 1999.

Depozitat dhe kreditë e bankave komerciale në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme:⁶

në 000 EUR

PËRSHKRIMI / PERIUDHA	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Depozita	427.194	514.045	692.296	838.584	923.260	1,111.234	1,424.684	1,749.684	1,901.868
Kredi	86.498	232.773	373.668	492.079	576.912	819.506	1,087.991	1,184.345	1,339.214
% kredi/depozita	20,2	45,3	53,9	58,7	62,5	73,75	76,37	67,68	70,42
Fitimi neto	2.716	6.801	10.349	13.229	19.297	33,780	32,075	24,836	36,566

⁵ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës: "Monthly Statistics Buletins" dhjetor/10

⁶ Shenimet e publikuara të bankave komerciale në gazetën e përditshme

Shuma e përgjithshme e depozitave në fund të vitit 2010 është më e lartë 335,20% në krahasim me vitin 2002 dhe 8,46% në krahasim me vitin 2009. Rritja e depozitave prej vitit në vit është rrjedhim i rritjes së besimit të klientëve (kursimtarëve) në bankat komerciale dhe rezultat i likuiditetit të lartë dhe të qëndrueshëm bankar.

Depozitat e afatizuara në fund të vitit 2010 kanë shënuar rritje në krahasim me vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008 dhe 2009 duke ndikuar në krijimin e kushteve për një politikë më të qëndrueshme kreditore:

(në 000 euro)

DEPOZITA	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Llogari rrjedhëse	278.697	296.607	319.008	284.809	365.147	520.184	565.425
Depozita të afatizuara	413.599	541.977	604.252	826.425	1.059.537	1.229.500	1.336.443
Gjithsej:	692.296	838.584	923.260	1.111.234	1.424.684	1.749.684	1.901.868

Për të ndikuar në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit, bankat komerciale, që nga viti 2003, e rritën përkrahjen financiare të aktiviteteve ekonomike përmes kreditimit të bizneseve të vogla, të mesme dhe personave individualë (fizikë) për destinime të ndryshme.

Pjesëmarrja e shumës së përgjithshme të kredive (portofolio neto) në shumën e depozitave është rritur nga 20,2% në fund të vitit 2002 në 70,42% në fund të vitit 2010. Ndërsa shuma e përgjithshme e kredive është rritur për 14,48 % (mbi katërbëdhjetë herë) në fund të vitit 2010, në krahasim me vitin 2002 dhe për 13,08% në krahasim me vitin 2009.

KREDITË NË FUND TË VITIT 2010 JANË SHFRYTEZUAR ME KËTË STRUKTURË BRENDA EKONOMISË:

tregti	720.200.000 euro	ose	53,78%
industri	268.500.000 euro	ose	20,05%
bujqësi	38.300.000 euro	ose	2,86%
të tjera	312.214.000 euro	ose	23,31%
GJITHSEJ:	1.339.214.000 euro	ose	100%

Në kuadër të ekonomisë, bujqësia shfrytëzoi më së paku kredi edhe pse ka resurse për një zhvillim shumë më të lartë. Në zhvillimin më të lartë të bujqësisë mund të ndikohet me ndërmarrjen e masave stimuluese të politikës fiskale e doganore, me kredi me afat më të gjatë të shfrytëzimit dhe normë më të ulët të interesit, etj. Ndërkaq, shfrytëzimi i ulët i kredive në industri rezultoi me mosinteresimin e investuesve të huaj për shkak të moszgjidhjes së statusit të Kosovës, përkatësisht garantimit të investimeve.

Rritja e afarizmit të bankave komerciale (niveli i kredive dhe i shërbimeve të tjera) në vitin 2010 rezultoi me realizimin e fitimit neto në shumën prej 36.6 mil. EUR.

Mjetet e lira të depozitave, pas shfrytëzimit për kredi dhe sigurimit të likuiditetit minimal të bankave, bankat komerciale i kanë plasuar në bankat korrespondente me normë më të ulët të interesit.



7. Vështrim mbi afarizimin e Bankës Ekonomike gjatë vitit 2010

7. Vështrim mbi afarizimin e Bankës Ekonomike gjatë vitit 2010

Banka Ekonomike, në fund të vitit 2010, ka realizuar shumën e aktivës me 125 mil. EUR dhe shumën e përgjithshme të bilancit me 132,7 mil. EUR, duke përfshirë zërat jashtëbilancorë. Në krahasim me vitin 2009, shuma e përgjithshme e aktivës ishte më e lartë për 26,68%.


Ne vitin 2010, Banka Ekonomike e përmbylli bilancin me rezultat negativ (612.000 EUR).

Ecuritë e realizuara afariste të Bankës Ekonomike në fund të vitit 2010 (numri i llogarive të klientëve, depozitat dhe kreditë) ishin mbi nivelin e vitit paraprak.

Tashmë Banka Ekonomike ka 47 degë ne mbarë territorin e Kosovës, pra është prezente kudo. Rrjeti i bankomatëve (ATM-ëve) është në rritje e sipër. Në fund t vitit 2010, Banka Ekonomike ka pasur 32 ATM në funksion, të cilët kanë shërbyer që klientët të kenë qasje në llogarinë e tyre 24 orë.

Ecuritë e aseteve të Bankës Ekonomike nga viti 2007, janë si më poshtë:

Asetet e Bankës 2007 – 2010



7.1 Numri i llogarive të klientëve

Numri i llogarive të klientëve të Bankës Ekonomike ka shënuar rritje të vazhdueshme prej viti në vit dhe në fund të vitit 2010 ka arritur në 76.617, me këtë strukturë:


PËRSHKRIMI VITI	2006	%	2007	%	2008	%	2009	%	2010	%
Persona juridikë	3.644	8.7	4.119	8.7	2.376	4.4	4.248	6.5	4.627	6.0
Persona fizikë	38.421	91.3	43.380	91.3	51.678	95.6	61.010	93.5	71.990	94.0
Gjithsej:	42.065	100	47.499	100	54.054	100	65.258	100	76.617	100

Numri i përgjithshëm i llogarive të klientëve në fund të vitit 2010 është rritur 17,40 % në krahasim me vitin e kaluar.

7.2 Kreditimi

Banka Ekonomike ka arritur sukses dhe rritje të konsiderueshme në financimin e sektorëve: për Biznese të Vogla, për Biznese të Mëdha dhe për Persona Fizikë.

Numri i kredive është rritur vazhdimisht, gjë që tregon se banka në fokus të veçantë i ka sektorët e kredive të vogla dhe ato të personave fizikë.




Portfolio e kredisë ka shënuar rritje edhe gjatë vitit 2010. Shuma e protfolios së kredisë, përfshirë mbitërheqjet dhe garancitë bankare kap shumën prej 90,2 milionë EUR apo rritje prej 39,4% krahasuar me vitin 2009.



7.3 Depozitat

Banka Ekonomike, në fund të vitit 2010, realizoi shumën e përgjithshme të depozitave prej 111,3 milionë EUR, përkatësisht 31,70% më shumë se në vitin e kaluar. Ecuritë e depozitave nga viti 2007 deri në vitin 2010 janë si më poshtë:

Depozitat 2007 - 2010



Struktura e depozitave është si më poshtë:

(në 000 euro)

PËRSHKRIM VITI	2006	%	2007	%	2008	%	2009	%	2010	%
Depozita me afat	29.748	68.7	31.891	71.7	52.944	73.0	65.188	77.1	88.549	79.5
Depozita pa afat	13.540	31.3	12.614	28.3	19.654	27.0	19.347	22.9	22.789	20.5
Gjithsej:	43.288	100	44.505	100	72.599	100	84.535	100	111.338	100

Rritja e pjesëmarrjes së depozitave me afat në shumën e përgjithshme të depozitave, prej viti në vit, ka rezultuar me forcimin e besimit të kursimtarëve në Bankën Ekonomike.

Njësia e Thesarit është e përqendruar vazhdimisht në këmbime me valuta të huaja, në menaxhimin e likuiditetit, plasimin e fondeve në bankat korrespondente, me menaxhimin e riskut të normës së interesit etj.

Këmbimet e huaja

Banka ka mirëmbajtur pozicionin e valutave të huaja brenda limiteve dhe vëllimin kryesor e ka pasur në valutat e huaja të USD dhe CHF. Duke pasur parasysh lëvizjet që kanë pasur gjatë vitit 2010 këto dy valuta ndryshimet e kursit kanë akumuluar profit.

Rreziku i likuiditetit

Njësia e Thesarit monitoron dhe mirëmban pozicionet e kesh-it dhe të likuiditetit në baza ditore, mujore dhe deri në 1 vit për të siguruar që një shkallë e lartë e likuiditetit është duke u mirëmbajtur. Banka vazhdimisht monitoron profilin e gap-it. Metodatat e përdorura për matjen e rrezikut të likuiditetit janë analiza e gap-it dhe proporcionet e likuiditetit. Limitet e përcaktuara nga BQK, lidhur me proporcionet e likuiditetit, janë mirëmbajtur vazhdimisht.

Komisioni i Aktivës dhe i Pasivës (ALCO), në mbledhjet e rregullta, është përgjegjës për menaxhimin e strukturës së pozicioneve të bilancit të gjendjes, që kontrollon rrezikun e likuiditetit dhe rreziqet e tjera në përgjithësi, e po ashtu edhe adresimin e rezultateve të portofolios së kredive. Në ALCO diskutohet pajtueshmëria me limitet e jashtme dhe të brendshme, rreziku i menaxhimit të plasmaneve, analizat e mirëmbajtjes së likuiditetit, analizat e depozitave, investimet e ndryshme, ekspozimet e depozitave/kredive dhe mirëmbajtja e ekspozimeve të ndryshme që kanë ndikim në Aktivën dhe Pasivën e Bankës.

Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit

Banka analizon rrezikun ndaj normave të interesit dhe ndjeshmërinë e marzhës së interesit dhe të vlerës së tregut të ndryshimet në normat e interesit. Kjo ndjeshmëri arrihet nga gap-i të të dhënat e maturitetit dhe rishikimi i normave të interesit të aktivës dhe të pasivës.

Rreziku ndaj normave të interesit kalkulohet sipas metodës së kohëzgjatjes së gap-it. Gap-i i normave të interesit fokusohet në mospërputhjet ndërmjet ndryshimeve të vlerave të aseteve dhe të obligimeve. Kjo na pasqyron strukturën e bilancit të gjendjes dhe na lejon të dallojmë koncentrimin e maturitetit të normave të interesit.




7.5 Qarkullimi i pagesave

Transferet vendore

Qarkullimi i pagesave vendore në kuadër të Departamentit të Operativës gjate vitit 2010 ka shënuar rritje të konsiderueshme, që tregon një sukses të Bankës në zgjerimin e biznesit të saj.


Shuma totale e transfereve përmes sistemit të kliringut ka qenë 381.656.779 EUR, ku nga këto transfere kliring hyrëse kanë qenë 158.239.315,49 EUR apo krahasuar me vitin 2009 është shënuar rritje prej 21,57%, ndërsa transferet kliring dalëse kapin shumën prej 223.417.464,31 EUR apo 12.52% rritje në krahasim me vitin 2009.



Transferet ndërkombëtare

Duke pasur parasysh krizën globale që kaploi tërë botën, e si rezultat i saj importet dhe eksportet kanë rënë dukshëm, transferet ndërkombëtare gjatë vitit 2010 kanë shënuar rritje të kënaqshme.

Vlera e përgjithshme e qarkullimit të transfereve ndërkombëtare në fund të vitit 2010 ka qenë 147.910.776 EUR, e nga këto, transfere ndërkombëtare hyrëse kanë qenë 85.161.046,10 EUR apo, krahasuar me vitin 2009, kanë shënuar rritje 8,52%, kurse dalëse kanë qenë 62.749.730 EUR apo, krahasuar me vitin 2009, kanë shënuar rënie prej -15.74%.



Realizimi i këtyre transfereve mundësohet përmes bankave tona korrespodente:

LHB Iternacionale Handelsbank, Frankfurt, Gjermani

RZB Raiffaisen Zentralbank Oesterich AG, Vjenë, Austri

Intesa Sanpaolo, Tiranë, Shqipëri

Deutsche Bank AG, Frankfurt Gjermani, dhe New York, USA



BANK AUSTRIA, Unicredit Group, Austri

NLB Slovenia, Slloveni



GARANCIONET DHE LETËRKREDITË

Garancionet dhe Letërkreditë, gjatë viti 2010, kane shënuar rritje si për nga vlera ashtu edhe për nga numri.



7.6 Menaxhimi i riskut kreditor

Gjatë vitit 2010 është punuar shumë në përmirësimin e kualitetit të portfolios së kredisë si dhe në menaxhimin e kësaj portfolio.

Gjatë vitit 2010 kemi pasur rritje të kënaqshme të portfolios së kredisë, mirëpo ky vit ka vazhduar të jete i ndikuar nga kriza globale dhe, si rezultat i kësaj, Banka, gjatë vitit 2010 ka ndarë rreth 3.056.285 EUR rezervë shtesë.

Kohë pas kohe, janë mbajtur trajnime për të gjithë analistët kreditorë në mënyrë që të jenë sa më të përgatitur për të bërë analizë financiare gjatë vizitave që u bëhen klientëve. E tërë kjo është bërë me qëllim zvogëlimi të rrezikut apo evidentimit të rrezikut të mundshëm.

Gjithashtu është arritur që sistemi i raportimit lidhur me kredi, mbitërheqje dhe garancione, të jetë i automatizuar, dhe, gjatë vitit 2010, janë bërë shumë raporte për kredi të cilat shërbejnë për infomim më të shpejtë dhe më të saktë për rrezikun kreditor.

Njësia për kreditë problematike që nga fillimi ka qenë shumë aktive dhe qëllimi kryesor i saj është vizita dhe presioni ndaj klientëve që janë në vonesë, klientëve problematikë dhe atyre të paditur.

Janë realizuar shumë vizita klientëve në fjalë dhe ato kanë rezultuar me sukses për arkëtimin e mjeteve nëpërmjet presionit të vazhdueshëm ndaj klientëve problematikë si dhe për informimin e tyre se vonesat nuk do të tolerohen.

Gjithashtu në Departamentin e Riskut është formuar njësi e riskut operacional, qëllimi i të cilës është që të avancohet menaxhimi i risqeve operacionale. Risku operacional ka për qëllim sidomos që të sigurojë qasje të përmirësuar të menaxhimit dhe të matjes së rrezikut operaciona. E tërë kjo bëhet në mënyrë që të forcohet kontrolli, të përmirësohet shërbimi ndaj kosumatorëve dhe të minimizohen humbjet që, gjatë punës në bankë, shkaktohen nga faktorët e brendshëm dhe nga faktorët e jashtëm.

7.7 Burimet njerëzore

Departamenti i Burimeve Njerëzore, gjatë vitit 2010, ka vazhduar të investojë në trajnimin dhe motivimin e punëtorëve të Bankës. Si rezultat i kësaj, punëtorët janë përgatitur në aspektin profesional dhe janë shumë produktivë në punë.

Gjatë vitit 2010, të gjitha politikat dhe procedurat e ndryshuara në bazë të Ligjit të Punës nga Departamenti i Burimeve Njerëzore kanë hyrë në funksion të plotë dhe zbatohen nga të gjithë punëtorët e Bankës.

Banka Ekonomike, gjatë vitit 2010, ka punësuar 76 punëtorë, duke e rritur numrin e punëtorëve në 354, prej të cilëve 324 me orar të plotë dhe 30 me gjysmë orari të punës. Ndërprerje të marrëdhënies së punës gjatë vitit 2010 kanë bërë 19 punëtorë.

Banka Ekonomike për të gjithë punëtorët ofron Sigurimin Shëndetësor dhe Sigurimin Aksidental. Gjithashtu, përveç kontributeve të rregullta pensionale, Banka Ekonomike paguan edhe kontribute vullnetare pensionale për të gjithë punëtorët në Fondin Slloveno- Kosovar të Pensioneve.

Gjatë vitit 2010, angazhimi më i madh i Departamentit të Burimeve Njerëzore ka qenë në trajnimin e stafit për fushat më të rëndësishme të Sistemit Bankar e sidomos për shitjen dhe mënyrën e qasjes ndaj klientit

Gjatë vitit 2010 janë trajnuar 189 punëtorë në 10 module të ndryshme të trajnimeve . Banka Ekonomike ofron kushte shumë të mira të punës për të gjithë punëtorët.



7.8 Marketingu

Krijimi dhe formimi i identitetit të Bankës Ekonomike ka ushtruar ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në krijimin e marrëdhënieve të ndërsjella të besueshme me klientët e vet gjatë gjithë këtyre viteve, e gjithashtu edhe me shoqërinë në tërësi.

Banka Ekonomike do të vazhdojë të veprojë si bankë vendore duke ofruar shërbime moderne bankare për klientët e saj dhe potencial të mjaftueshëm, duke qenë gjithnjë më konkurrenente në sistemin bankar.

Për të përmbushur të gjitha këto, gjatë vitit 2010, Banka Ekonomike ka qenë mjaft aktive edhe me fushata të ndryshme marketingu, ku klientëve u janë ofruar oferta të veçanta për produkte dhe shërbime bankare me ç'rast Banka ka komunikuar dhe informuar klientët rregullisht në lidhje me produktet dhe shërbimet bankare nëpërmjet të gjitha kanaleve të komunikimit.

Departamenti i Marketingut ka zhvilluar fushata të ndryshme marketingu gjatë lansimit të produkteve dhe të shërbimeve ekzistuese dhe të reja, siç janë:

Fushata e afatizimeve, E-banking, Kartelat Ndërkombëtare Visa dhe MasterCard dhe Paketa e Kredisë.

Gjithashtu kemi qenë të përkushtuar në renovimin, pozicionimin, zhvillimin dhe zgjerimin e rrjetit të degëve dhe nëndegëve.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar gjithashtu zgjerimit të rrjetit të bankomatëve dhe deri në fund të vitit 2010 numri i Atm-ve arrin në 32.



Pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit

Raporti i auditorit të pavarur së bashku me pasqyrat financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2010 të përgatitura në përputhje me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	32
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	33
PASQYRA GJITHËPËRFSHIRËSE E TË ARDHURAVE	34
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	35
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	36
SHËNIMET NË PASQYRAT FINANCIARE	38

Raporti i auditorit të pavarur



Deloitte Kosova sh.p.k. Tel: +381 38 245 582/3
St. Bedri Pejani, no.3 Fax: +381 38 245 584
10030 Prishtinë 3 Web: www.deloitte.com
Republic of Kosova

Për aksionarët e Bankës Ekonomike Sh. a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Ekonomike Sh.a ("Bank"), ku përfshihen pasqyra e pozitës financiare deri më 31 Dhjetor 2010, dhe pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për fund vit, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen korrekte të këtyre pasqyrave financiare në pajtim me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK") siç shpjegohet në shënimin 2, dhe për kontrollin e brendshëm të tillë që menaxhmenti e përcakton si të nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë deklarata materialisht të gabuara, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim opinion mbi pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike si dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimet e rrezikut për gabimet materiale në pasqyra financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në arritjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit në mënyrë që të përcaktoj procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo edhe për qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi po ashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël që bëhen nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat e opinionit tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës deri më 31 Dhjetor 2010, performancën e saj financiare dhe rrjedhjet e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhje me rregullat dhe rregulloret e BQK-së ashtu siç shpjegohet në shënimin 2 të pasqyrave financiare.

Ky është përkthimi i Raportit Original për pasqyrat financiare i lëshuar në gjuhën angleze, në rast të mospërputhjes do të mbizotëroj versioni në gjuhën angleze.

Prishtinë, Kosovë
3 Maj 2011

Pasqyra e pozitës financiare Deri më 31 Dhjetor 2010


ASETET	SHËNIMI	Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Paraja në dorë dhe në banka	4	25,581	18,757
Balancat me BQK-në	5	9,554	14,008
Kreditë e dhëna klientëve	6	87,235	63,605
Prona dhe pajisjet	7	1,414	1,239
Pasuria e paprekshme	8	53	78
Parapagimet për tatimin nga të hyrat e korporatës	-	82	42
Asetet tjera	-	1,081	956
Totali i asetëve		125,000	98,685
Detyrimet			
Depozitat e klientëve	9	113,005	85,558
Të hyrat nga tarifat e shtyra	-	556	402
Llogaritë e pagueshme	10	171	174
Totali i detyrimeve		113,732	86,134
Ekuiteti i Aksionarëve			
Kapitali aksionar	11	11,778	11,778
Rezerva e përgjithshme e rrezikut	12	102	102
(Humbja)/ fitimi i akumuluar		(612)	671
Totali i ekuitetit të aksionarëve		11,268	12,551
Totali i detyrimeve dhe ekuitetit të aksionarëve		125,000	98,685

Autorizuar për lëshim nga Menaxhmenti i Bankës me 3 Maj 2011.



Z. Valon Lluka

Drejtor i përgjithshëm



Znj. Syzane Kaçaniku

Drejtoreshë e financave

Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave Për fund vitin 31 Dhjetor 2010

(në Euro 000)

	Shënimi	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2010	Viti i përfunduar me 31 Dhjetor 2009
Të hyrat nga interesi:			
Nga kreditë e dhëna klientëve	-	9,032	7,564
Nga depozitat dhe balancat me bankat	-	44	99
Totali i të hyrave nga interesi		9,076	7,663
Shpenzimet e interesit në detyrimet nga			
kostoja e amortizimit	-	(3,626)	(2,712)
Neto të hyrat nga interesi		5,450	4,951
Të hyrat nga komisionet dhe tarifat	13	1,758	1,563
Shpenzimet nga komisionet dhe tarifat	-	(113)	(108)
Të hyrat neto nga komisionet dhe tarifat		1,645	1,455
Të hyrat tjera operuese	14	284	485
Fitim neto nga shkëmbimi i valutave të huaja	-	79	11
Totali i të hyrave		7,458	6,902
Shpenzimet e tjera operuese	15	(5,014)	(4,117)
Provizionimi për humbjet nga kreditë	6	(3,056)	(2,036)
Totali i shpenzimeve operuese		(8,070)	(6,153)
Fitimi para tatimit të të hyrave		(612)	749
Shpenzimet e tatimit të të hyrave	16	-	(78)
Fitimi neto për vitin		(612)	671
Të hyrat tjera	-	-	-
Totali i të hyrave tjera		(612)	671

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet Për fund vitin 31 Dhjetor 2010

(në Euro 000)

	Kapitali Aksionar	Rezerva e përgjithshme e rrezikut	Fitimi i mbajtur	Totali i ekuitetit
Balanca me 1 Janar 2009	10,764	102	1,014	11,880
Kapitalizmi i fitimit	1,014	-	(1,014)	-
Neto fitimi i vitit	-	-	671	671
Balanca me 31 Dhjetor 2009	11,778	102	671	12,551
Divident paguar	-	-	(671)	(671)
Neto fitimi i vitit	-	-	(612)	(612)
Balanca me 31 Dhjetor 2010	11,778	102	612	11,268

Pasqyra e rrjedhës së parasë Për fund vitin 31 Dhjetor 2010

(në Euro 000)

	Shënimi	Fund viti 31 Dhjetor 2010	Fund viti 31 Dhjetor 2009
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operuese			
Fitimi para tatimit	-	(612)	749
Korrigjimet për zërat jo-kesh:			
Zhvlerësimi	-	556	452
Amortizimi	-	29	30
Humbjet neto në kredi ndaj klientëve	-	3,056	2,036
Humbjet në dispozicion të pronës dhe pajisjeve	-	21	409
Shpenzimet e interesit	-	3,739	2,820
Të hyrat nga interesi	-	(10,790)	(9,226)
		(4,001)	(2,730)
(Zvogëlimi)/rritja në balancat me BQK	-	4,454	(10,297)
Rritja në kredi ndaj klientëve	-	(26,628)	(11,672)
(Rritja)/zvogëlimi në asetet tjetra	-	(125)	189
Rritja në depozita nga klientët	-	26,803	11,936
(Zvogëlimi)/rritja në detyrimet tjera	-	(3)	48
Rritja në të hyrat e shtyra	-	153	246
		653	(12,280)
Tatimi në të hyra i paguar	-	(40)	(275)
Interesi i paguar	-	(3,095)	(2,867)
Tatimi i pranuar	-	10,733	8,585
Neto paraja nga aktivitetet operuese		8,251	(6,837)

(në Euro 000)

Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investive	Shënimi	Fund viti 31 Dhjetor 2010	Fund viti 31 Dhjetor 2009
Blerja e pronës dhe pajisjeve	-	(752)	(412)
Blerjet e pasurive të paprekshme	-	(4)	(25)
Të ardhurat nga shitja e pronës dhe pajisjeve	-	-	-
Neto paraja e përdorur në aktivitetet		(756)	(437)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese	-	-	
Divident paguar gjatë vitit	-	(671)	-
Neto paraja nga aktivitetet financuese		(671)	-
Neto rritja / (zvogëlimi) në para dhe ekuivalentët e parasë	-	6,824	(7,274)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 1 Janar		18,757	26,031
Paraja dhe ekuival. e saj me 31 Dhjetor	4	25,581	18,757

Shënime për pasqyrat financiare

Për fund vitin 31 Dhjetor 2009

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

1. AKTIVITETET KRYESORE

Në përputhshmëri me Bankën Qendrore të Kosovës ("BQK"), Banka Ekonomike Sh.a. Prishtinë ("Banka") mori licencën për zhvillimin e aktivitetit bankar më 28 Maj 2001 dhe filloi operimin e saj më 5 Qershor 2001. Zyra qendrore e Bankës gjendet në Rr. Migjeni Nr.1, Prishtinë, Kosovë. Banka operon njëkohësisht si bankë tregtare dhe kursimi për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës, përmes rrjetit të saj prej 7 degësh të shtrira në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjiilan.

2. BAZA PËR PËRPILIM

Banka mirëmban librat kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhshmëri me koston historike dhe rregullat kontabël të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK" rregulloret) që janë të aplikueshme për bankat. Rregulloret e BQK-së janë të bazuara në vendimet legale relevante që definojnë aplikimin e obligueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") në Kosovë, por rregulloret e BQK-së gjithashtu kërkojnë në mënyrë specifike aplikimin e trajtimeve kontabël që nuk janë në përputhshmëri me kërkesat specifike të SNRF. Si pasojë, këto pasqyra duhet të lexohen (interpretohen) si të përgatitura në përputhshmëri me standardet kontabël dhe rregulloret që mbizotërojnë në territorin e Kosovës që janë shpallur në politikat kryesore kontabël të dhëna më poshtë në shënimin 3.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhshmëri me rregulloret e BQK-së, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe parashikime që ndikojnë në shumat e raportuara të asetëve dhe detyrimeve, shpallje të asetëve dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrave financiare, dhe shumën e tyre të raportuar të të hyrave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Edhe pse këto vlerësime janë të bazuara në njohuritë më të mira të menaxhmentit për ngjarjet e tanishme dhe veprimet, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

a) Valuta e prezantimit

Valuta e raportimit të Bankës është Euro, e cila është valutë legale në territorin e Kosovës që nga 1 Janari 2002.

b) Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje për të gjitha instrumentet që sjellin interes në bazë aktuale duke përdorur metodën efektive të të ardhurave bazuar në çmimin aktual të blerjes, përveç për kreditë ku mbledhja është e pasigurt, të hyrat nga interesi njihen në bazë të arkëtimit.

c) Rezervat e detyrueshme të likuiditetit

Në përputhje me rregulloret e BQK-së banka duhet të arrijë mesataren minimale të kërkesave të likuiditetit. Kërkesat e likuiditetit janë të përlogaritura në baza mujore si 10% e depozitave bazë, e përcaktuar si mesatare totale e detyrimeve ndaj depozitave në pjesën jo-bankare-publike në Euro dhe monedhave tjera gjatë ditëve të punës të periudhës së mirëmbajtjes. Asetet me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat për likuiditetin e saj janë Euro depozitat me BQK-në dhe 50% e ekuivalentëve të parasë të denominuara në valuta lehtë të konvertueshme. Depozitat me BQK nuk duhet të jenë më të ulëta se 5% e bazës së depozitave të aplikueshme.

Përderisa asetet përkatëse likuide nuk janë në dispozicion për financim të operacioneve të përditshme bankare, ato nuk janë përfshirë te parajsa dhe ekuivalentët e parasë për qëllime të rrjedhës së parasë.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

d) Tarifat dhe të hyrat nga komisionet

Të hyrat nga tarifat dhe komisionet janë njohur në bazë akruale kur shërbimi ka ndodhur. Detyrimet ndaj tarifave të kredive që mund të lëshohen janë shtyrë (bashkë me kostot relevante direkte) dhe njohur si korigjim te norma efektive e interesit në kredi.

e) Kreditë e klientëve

Kreditë e lëshuara nga Banka duke u siguruar paratë drejtpërdrejtë huamarrësve janë kategorizuar si kredi ndaj klientëve.

Kreditë e lëshuara dhe paradhëniet njihen në momentin kur paratë u lëshohen huamarrësve. Fillimisht, kreditë e lëshuara dhe paradhëniet janë të regjistruara sipas kostos, e cila është vlera e tregut e pagesës së dhënë, dhe më pas janë mbajtur sipas kostos së amortizuar të zvogëluar për provizionin për kreditë e këqija.

Provizioni për rrezik të kredisë për kreditë e këqija është bërë në qoftë se ka prova objektive se banka nuk do të jetë në gjendje të mbledhë shumat sipas kushteve kontraktuale. Shuma e provizionit përcaktohet në bazë të Rregullave të BQK-së e rregulluar për shumat e rikuperueshme nga garancitë dhe kolaterali.

Provizioni për kreditë e këqija mbulon edhe humbjet e përgjithshme, ku ka dëshmi objektive se humbjet e mundshme janë të pranishme në komponentët e portofolit të kredisë në datën e bilancit të gjendjes. Këto janë llogaritur në bazë të modeleve historike të humbjeve në secilën komponentë, rangimit të kredive të caktuara për huamarrësit dhe reflektojnë mjedisin aktual ekonomik në të cilin veprojnë huamarrësit.

Kur një kredi konsiderohet e paarketueshme, ajo shlyhet nga provizioni i caktuar për kreditë e këqija. Kredi të tilla shlyhen pasi të gjitha procedurat e domosdoshme janë ndërmarrë dhe shumat e humbjeve është përcaktuar. Kthimet e mëvonshme të shumave të kredisë të cilat paraprakisht janë shlyer janë kredituar në fitimin ose humbjen e periudhës.

Nëse shumat e provizionit për kreditë e këqija me vonë zvogëlohet si pasojë e ndonjë ngjarje pas shlyerjes, atëherë zvogëlimi i provizionit kreditohet në provizionin për shlyerjen e kredive në fitim ose humbje.

Në vazhdim kemi klasifikimin e kategorive dhe shkallet e provizioneve minimale siç është caktuar nga BQK-ja:

KATEGORITË	NORMA E PROVIZIONIT
Nën-standarde	20%
Të dyshimta	50%
Humbje	100%

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

Përveç provizioneve specifike të kërkuara ndaj ekspozimeve të klasifikuara, banka bën provizion të përgjithshëm ndaj portfolios të mbetur, jo të klasifikuar ose pjesëve të portfolios. Provizioni i përgjithshëm, bëhet bazuar në përvojën e dokumentuar historike, e rregulluar për kushtet e tanishme dhe të mundshme të tregut.

f) Valutat e huaja

Transaksionet në valuta të huaja të ndryshme nga Euro regjistrohen sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit që rrjedhin nga rregullimi i transaksioneve të denominuara në valuta të huaja janë përfshirë në fitim ose humbje duke përdorur kursin e këmbimit të asaj date.

Asetet monetare dhe detyrimet e denominuara në valuta të huaja janë shndërruar në Euro sipas vlerës mesatare të kursit të këmbimit në datën e bilancit të gjendjes. Zërat jo-monetar që janë denominuar në valuta të huaja që mbahen me vlerën e tyre të tregut, janë rishndërruar në valutën funksionale me normat e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e tregut. Zërat jo-monetar që janë matur sipas kostos historike në valutë të jashtme nuk janë rishndërruar në valutën funksionale. Fitimet dhe humbjet e valutave të jashtme që rrjedhin nga shndërrimi i aseteve dhe detyrimeve janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave si fitim nga shndërrimi i këmbimit i jashtëm i zvogëluar për humbjet.

g) Prona, ndërtesat dhe pajisjet

Patundshmëritë, ndërtesat dhe pasjet janë vlerësuar në bazë të kostos duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe provizionin për heqjet nga përdorimi, aty ku kërkohet. Kosto përfshinë shpenzimet që janë direkt të përfshira në blerjen e pasurive. Aty ku njësi të një pasurie ose pajisjeje kanë vlerë të ndryshme të jetëgjatësisë, ato paraqiten ndaras si njësi të veçanta (komponentët me të mëdha) të pasurisë dhe pajisjeve.

Kosto e zëvendësimit të një pjese të pasurisë ose pajisjeve njihet në vlerën mbajtëse të njësisë, nëse pritet që përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me njësinë të rrjedhin dhe kostoja e tyre të mund të matet në mënyre të besueshme. Shpenzimet ditore për mirëmbajtjen e pasurisë dhe pajisjeve njihen në fitim ose humbje ashtu siç ndodhin.

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave sipas metodës drejtvizore bazuar në jetëgjatësinë e secilës pjese të pasurisë dhe pajisjeve. Pasuritë me qira zhvlerësohen për një periudhë më të shkurtë bazuar në marrëveshjen për qira dhe jetëgjatësinë së tyre. Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën e tashme dhe krahasuese është si më poshtë:

KATEGORITË E PASURIVE

NORMAT E ZHVLERËSIMIT TË PËRDORURA

Pajisjet kompjuterike	5 vite
Veturat	5 vite
Mobilet dhe pajisjet	5 vite

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

h) Pasuritë e paprekshme

Softueri i blerë nga Banka është vlerësuar sipas kostos duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e dëmtimeve të akumuluar. Shpenzimet e më pasme të softuerit kapitalizohen vetëm atëherë kur i rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të pasurisë specifike me të cilat kanë të bëjnë. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen siç ndodhin.

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave sipas metodës drejtvizore duke u bazuar në vlerësimin e jetëgjatësisë së softuerit, nga data që është futur në përdorim. Jetëgjatësia e softuerit konsiderohet të jetë dhjetë vite.

l) Humbja e vlerës së pasurive

Rënia në vlerë e aktiveve të Bankës vlerësohet në bazë të dispozitave Ndërkombëtare të Kontabilitetit Standardi nr. 36 "Rënia në vlerë e Aseteve". Ky standard kërkon që një humbje nga rënia në vlerë të njihet kurdoherë që vlera bartëse e një pasurie e tejkalon shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e një pasurie është më e larta e çmimit neto të shitjes dhe vlerës së saj në përdorim. Vlera në përdorim e një pasurie është vlera e tashme e rrjedhës së parasë që pritet të rrjedhë në të ardhmen nga përdorimi i vazhdueshëm i një pasurie dhe nga hedhja, shitja e saj.

j) Lizingu

Qiratë klasifikohen si qira financiare sa herë që kushtet e qirasë transferojnë në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë të qiramarrësi. Të gjitha kontratat e tjera janë të klasifikuara si qira operative.

Pagesat e bëra nën qiratë operative njihen në fitim ose humbje sipas metodës lineare gjatë afatit të qirasë. Rritjet e pranuar janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale për qira, gjatë kohëzgjatjes të qirasë.

k) Tatimi

Tatimi në të hyra është llogaritur në bazë të rregullave të aplikueshme për tatimin në të hyra në Kosovë, duke përdorur normat e tatimit në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Në fuqi që nga 1 Janari 2009, norma e tatimit në të hyrat e korporatës është caktuar 10%, në përputhje me rregulloret e tatimeve aktualisht në fuqi të Kosovës, Ligji nr. 03/L-113 " Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave".

Tatimin në të hyra i ngarkuar në fitim ose humbje përmban tatimin aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë, nëse ka ndonjë. Tatimi aktual është llogaritur në bazë të fitimit të tatueshëm që pritet për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi ashtu siç është raportuar në fitimi ose humbje sepse përjashton zërat e të hyrave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet tjera dhe atë më tej përjashton zërat që nuk janë të tatueshëm ose të zbritshëm. Tatimet tjera të ndryshme nga tatimet në të hyra janë regjistruar në shpenzime operative.

Tatimi i shtyrë në të hyra është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit të gjendjes për të gjitha ndryshimet e përkohshme që rrjedhin ndërmjet bazës së tatimit të pasurive dhe detyrimeve dhe shumave të tyre të bartura për qëllime të raportimit financiar.

Detyrimet në tatimin e shtyrë janë njohur për të gjitha ndryshimet e përkohshme të tatueshme. Pasuria në tatimin e shtyrë është njohur për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, e mbajtur nga pasuritë tatimore të papërdorura dhe humbjet tatimore të papërdorura, deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë në dispozicion kundrejt të cilit këto diferenca të përkohshme të zbritshme, të bartura nga pasuritë tatimore të papërdorura dhe humbjet tatimore të papërdorura mund të përdoren.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

Shuma e mbajtur e pasurive në tatimin e shtyrë në të hyra rishikohet në çdo datë të bilancit të gjendjes dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është më e mundshme që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm do të jetë në dispozicion që të mundësojë që e gjithë ose një pjesë e pasurisë në tatimin e shtyrë në të hyra të shfrytëzohet

Pasuria dhe detyrimet në tatimin e shtyrë në të hyra janë matur me norma tatimore që pritet të zbatohet në periudhën kur pasuria realizohet ose detyrimi është vendosur, në bazë të normave tatimore (dhe ligjeve tatimore) që kanë qenë në fuqi ose kanë hyrë në fuqi në datën e bilancit të gjendjes.

l) Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e saj janë zëra që mund të konvertohen në kesh në kohë të shkurtër (me më pak se tre muaj maturim) dhe të cilat janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimit në vlerë. Shumat që kanë të bëjnë me fondet që janë të një natyre të kufizuar janë përjashtuar nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë.

m) Zotimet jashtë bilancore

Gjatë rrjedhës e zakonshme të biznesit banka hyn në zotime të lidhura me kredi, që janë të regjistruara në llogari jashtë bilancore dhe kryesisht përfshijnë garancitë, letrat e kredisë dhe zotimet kreditore të pa tërhequra. Këto zotime financiare regjistrohen në bilancin e gjendjes së bankës kur bëhen të pagueshme. Provizioni për detyrimet e mundshme dhe rastet e humbjeve të detyrimeve kontingjente bëhen sipas rregulloreve të BQK-së.

n) Përfitimet/dobitë e punëtorëve

(I) Plani i definuar i kontributeve pensionale

Banka bën vetëm kontribute të detyrueshme për sigurim social të cilat japin përfitime pensionale për punëtorët deri në pensionim. Banka ka paguar vullnetarisht për çdo të punësuar 10 EUR çdo muaj kontribut pensional tek Skema e Fondit Silloven të Pensioneve. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për caktimin e pragut minimal të shumës për pensionet në Kosovë bazuar në një plan të definuar të kontributeve pensionale. Kontributet e Bankës për pensione ngarkohen në fitim ose humbje varësisht siç ndodhin.

(ii) Përfitimet afatshkurtra

Obligimet afatshkurtra për përfitimet e punëtorëve janë llogaritur në baza të padiskontuara (pazbritura) dhe janë shpenzuar kur shërbimi përkatës është ofruar.

Provizioni njihet për shumën që pritet të paguhet si bonus afatshkurtër në para ose si profit në planet pensionale përfituese, nëse Banka ka ndonjë detyrim ligjor ose të tërthortë për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të ofruara në të kaluarën nga punëtorët dhe nëse detyrimi mund të matet besueshëm.

o) Gjykime kritike të kontabilitetit dhe burimeve të vlerësimit të pasigurisë

Në zbatimin e politikave kontabël të bankës, të cilat janë përshkruar më sipër, nga menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumën bartëse të pasurive dhe detyrimeve që nuk janë të dukshme lehtë nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura janë bazuar në përvojën historike dhe faktorët tjerë që konsiderohen të jenë të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e ndodhura janë rishikuar në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve të kontabilitetit janë njohur në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm në atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon të dyja edhe periudhën aktuale edhe atë të ardhshme.

Kreditë e këqija të klientëve

Gjatë përcaktimit, nëse kreditë e klientëve kanë probleme në baza individuale kërkon vlerësimin e vlerës aktuale të rrjedhës së parasë që pritet nga kreditë e konsumatorëve duke përfshirë shumën e rikuperueshme nga garancitë dhe kolaterali. Menaxhmenti i bankës është duke përdorur gjykimin gjatë vlerësimit të rrjedhës së pritshme të parasë nga portofoli i kredive dhe marrja e kolateralit.

4. PARAJA E GATSHME NË DORË DHE PARAJA NË BANKA

	Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Paraja e gatshme në dorë	3,644	3,437
Llogaritë rrjedhëse me bankat	3,423	3,726
Depozitat njëditore	18,514	11,594
Totali i parasë në dorë dhe në banka	25,581	18,757

Depozitat njëditore të mbajtura në bankat jo-vendore marrin interes vjetor diku nga 0.09% deri 0.41% p.a. (2009: 0.15% to 0.50% p.a).

5. BALANCAT ME AUTORITETIN E BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS

Balancat me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK") të 9,554 mijë Euro me 31 Dhjetor 2010 (me 31 Dhjetor 2009: 14,008 mijë) paraqesin rezervë të obligueshme duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme për t'u mbajtur nën rregullat e BQK-se. BQK-ja paguan interes deri në shumën e plotë të rezervës minimale të likuiditetit të kërkuar (siç është përcaktuar në shënimin 3 (c). Gjatë vitit 2010 interesi është paguar në normën prej 0,1% në vit (2009: 0,1% p.a. deri 0,5% p.a.). Rezervat e kufizuara të likuiditetit bilancit me BQK-ën është e përjashtuar nga paraja dhe ekuivalentet e saj për qëllim të rrjedhës së parasë.

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

6. KREDITË PËR KLIENTËT

KREDITË	Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Kreditë afatshkurtra	11,678	4,676
Kreditë afatgjata	56,354	44,985
Mbitërheqjet	22,202	15,051
	90,234	64,712
Interesi i mbledhur	782	725
	91,016	65,437
Provizionet për kreditë e këqija	(3,781)	(1,832)
Kreditë për klientët	87,235	63,605

Kreditë afatgjata kanë afat të maturimit nga 1 deri në 5 vite. Gjatë fund vitit 31 Dhjetor 2010 banka i ka ngarkuar me interes klientët e saj nga 7% deri 22% p.a. (2009: 9% deri 22% p.a).

Lëvizjet në provizionime të kredive të këqija janë si më poshtë:

	2010	2009
Provizionimi për kreditë e këqija më 1 Janar,	1,832	947
Heqjet gjatë vitit për shkak të pamundësisë së arkëtimit	(1,107)	(1,151)
Shpenzimet e bëra gjatë periudhës	3,056	2,036
Provizionimi për kreditë e këqija më 31 Dhjetor	3,781	1,832

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

6. KREDITË PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Një analizë e industrisë e tërë portfolios së kredive të dhëna bizneseve para provizionimeve dhe interesit aktual jepet më poshtë:

SEKTORI INDUSTRIAL	Me 31 Dhjetor 2010		Me 31 Dhjetor 2009	
		%		%
Shitjet me shumicë	32,870	36	28,708	44
Prodhuese	2,421	3	1,219	2
Konsumuese	18,942	21	13,877	21
Shërbime	10,377	11	6,308	10
Hotele dhe restorante	1,433	2	661	1
Agrikulturë	549	1	469	1
Konstruksion	19,913	22	19,339	21
Të tjera	3,729	4	131	-
	90,234	100%	64,712	100%

Më 31 Dhjetor 2010, dhjetë huamarrësit më të mëdhenj të Bankës përfshijnë 48.27% (2009: 21.5%) nga tërë portfolio kreditorë. Ekspozimi i palëve të lidhura më 31 dhjetor 2010 është 106% e kapitalit (2009: 126%). Pasuese për datën e mbylljes së bilancit, ekspozimi ndaj palëve të lidhura është ulur në 89,7% si të 20 Prill 2011.

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

Analiza e balancave neto të kredive të dhëna klientëve me 31 Dhjetor 2010 është si më poshtë:

Kategoria e kredisë	Afati i maturimit	Norma e aplikuar e provizionit	Principal i mbetur dhe interesi akrual	Provizionimi për humbjet	Balanca në neto
Standarde	0 – 30 ditë	0% to 4%	82,181	81	82,100
Vrojtuese	31 – 60 ditë	0% to 10%	1,686	18	1,668
Nënstandarde	61 – 90 ditë	20% to 25%	3,826	765	3,061
Dyshimta	91 – 180 ditë	50%	823	412	411
Humbje	mbi 180 ditë	100%	2,500	2,500	-
Provizion për garantuesit			-	5	(5)
Neto kreditë e dhëna klientëve			91,016	3,781	87,235

Analiza e njëjtë për 31 Dhjetor 2009 është si vijon:

Kategoria e kredisë	Afati i maturimit	Norma e aplikuar e provizionit	Principal i mbetur dhe interesi akrual	Provizionimi për humbjet	Balanca në neto
Standarde	0 – 30 ditë	1%	58,258	235	58,023
Vrojtuese	31 – 60 ditë	5%	4,028	23	4,005
Nënstandarde	61 – 90 ditë	20%	1,596	317	1,279
Dyshimta	91 – 180 ditë	50%	618	316	302
Humbje	mbi 180 ditë	100%	937	937	-
Provizion për garantuesit			-	4	(4)
Neto kreditë e dhëna klientëve			65,437	1,832	63,605

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

7. PRONA NDËRTESAT DHE PAJISJET

Kosto:	Ndërtesat	Investimet në objektet e marra me qira	Inventari dhe paisjet	Kompjuterët dhe paisjet përkatëse	Veturat	Veturat me qira	Totali
Më 1 janar 2009	460	459	1,332	623	272	-	3,146
Shtesat gjatë vitit	-	56	249	55	-	52	412
Heqja nga përdorimi	(460)	-	(47)	(1)	-	-	(508)
Me 31 Dhjetor 2009	-	515	1,534	677	272	52	3,050
Shtesat gjatë vitit	460	96	449	48	159	-	752
Heqja nga përdorimi	-	-	(27)	(5)	(47)	-	(79)
Më 31 dhjetor 2010	-	611	1,956	720	384	52	3,723
Zhvlerësimi i akumuluar:							
Më 1 janar 2009	63	271	649	386	89	-	1,458
Shpenzimet për vitin	-	58	243	99	52	-	452
Heqja nga përdorimi	(63)	-	(35)	(1)	-	-	(99)
Me 31 Dhjetor 2009	-	329	857	484	141	-	1,811
Shpenzimet për vitin	-	77	299	108	61	11	556
Heqja nga përdorimi	-	-	(23)	(4)	(31)	-	(58)
Me 31 Dhjetor 2010	-	406	1,133	588	171	11	2,309
Vlera neto:							
Me 31 Dhjetor 2010	-	205	823	132	213	41	1,414
Me 31 Dhjetor 2009	-	186	677	193	131	52	1,239

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

8. PASURIA E PAPERKSHME

Softueri kompjuterik

Kosto:

Me 1 Janar 2009	256
Shtesat gjatë vitit	25
Me 31 Dhjetor 2009	281
Shtesat gjatë vitit	4
Me 31 Dhjetor 2010	285

Zhvlerësimi I akumuluar:

Me 1 Janar 2009	173
Shpenzimet për vitin	30
Me 31 Dhjetor 2009	203
Shpenzimet për vitin	29
Me 31 Dhjetor 2010	232

Vlera neto:

Me 31 Dhjetor 2010	53
Me 31 Dhjetor 2009	78

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

9. DETYRIMET NDAJ KLIENTËVE

	Me 31 Dhjetor 2010	Me 31 Dhjetor 2009
Llogaritë rrjedhëse		
Llogaritë rrjedhëse në Euro	15,064	13,398
Llogaritë rrjedhëse në valuta të huaja	1,095	288
Llogaritë e kursimit	6,257	4,956
Llogaritë e bllokuara	373	704
	22,789	19,346
Depozitat e afatizuara:		
Në Euro	85,584	63,265
Në valuta të huaja	2,966	1,924
	88,550	65,189
Interesi aktual	1,666	1,023
Totali	113,005	85,558

Llogaritë rrjedhëse nuk sjellin interes.

Për depozitat e afatizuara, normat efektive të interesit gjatë vitit 2010 ishin:

	1 muaj	3 muaj	6 muaj	1 vit	18 muaj	2 vite	3 vite	5 vite
	%	%	%	%	%	%	%	%
	2.4	3.0	4.0	4.9	5.1	5.2	5.4	6.0

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

Për depozitat me afat, normat efektive të interesit gjatë vitit 2010 ishin si më poshtë:

1 muaj	3 muaj	6 muaj	1 vit	18 muaj	2 vite	3 vite	5 vite
%	%	%	%	%	%	%	%
2.5	3.5	4.2	5.0	5.2	5.4	5.6	6.2

Normat e interesave vjetore të aplikuara nga Banka gjatë vitit 2010 dhe 2009 për secilën periudhë të maturimit të depozitave janë si më poshtë:

Lloji i klientit	Deri në 30 ditë	31 deri 90 ditë	91 deri 180 ditë	181 deri 270 ditë	271 ditë dhe më shumë
2010:					
Kompanitë	2,40%	3.00%	4.00%	-	4.9-6.0%
Individët	2,40%	3.00%	4.00%	-	4.9-6.0%
2009:					
Kompanitë	2.50%	3.50%	4.20%	4.20-5%	5-6.20%
Individët	2.50%	3.50%	4.20%	4.20-5%	5-6.20%

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

10. LLOGARITË E PAGUESHME

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Tatimet e tjera të pagueshme	59	51
Pensionet, asistencat sociale	18	20
Shpenzimet akruale	61	52
Lizingu financiar	33	51
Totali	171	174

11. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i autorizuar dhe paguar përbëhet nga 46,010 aksione të rregullta me vlerë nominale 256 Euro secila si me 31 Dhjetor 2010, në shumën prej 11,779 mijë Euro (31 Dhjetor 2009: 46,011 aksione të rregullta me vlerë nominale 256 Euro për aksion , në shumën prej 11,779 mijë Euro).

Në përputhshmëri me Rregullën Nr. XXI për "Rritja Minimale të Kapitalit të Bankës" autorizuar nën Seksionin 5 të Rregullës Nr.1999/21 lëshuar nga BQK-ja, minimumi i kapitalit të Bankës për të operuar në Kosovë duhet të jetë 5 milion Euro.

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

Një përmbledhje e aksionarëve të Bankës është si vijon:

Aksionari	Me 31 dhjetor 2010		Me 31 dhjetor 2009	
	Përqindja e pronësisë	(në Euro 000')	Përqindja e pronësisë	(në Euro 000')
Behgjet Pacolli	29.18	3,438	46.16	5,438
Hasan Hajdari	8.06	949	8.06	949
Raif Rexhepi	13.84	1,630	22.33	2,630
Xhabir Kajtazi	7.99	941	7.93	934
Zyhra Hajdari	4.78	563	4.78	563
Ismet Gjoshi	4.21	496	4.21	496
Afrim Pacolli	15.84	1,865	3.10	366
Selim Pacolli	13.79	1,625	1.05	124
Dukagjini- Operativa	0.54	64	0.54	64
Të tjerët me më pak se 1%	1.77	207	1.84	215
	100	11,778	100	11,779

Tabela më poshtë tregon lëvizjet në kapitalin aksionar gjatë vitit

	2010 në Euro 000'	2009 në Euro 000'
Gjendja me 1 janar,	11,778	10,764
Profiti i kapitalizuar gjatë vitit,	-	1,014
Balanca me 31 dhjetor	11,778	11,778

Aksionet janë të zakonshme në natyrë dhe nuk kanë të drejta, preferenca ose kufizime të bashkangjitura me to.

12. REZERVA E PËRGJITHSHME E RREZIKUT

Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të Bankës i cili është aprovuar nga aksionarët në asamblenë e përgjithshme të Bankës të mbajtur me 28 Prill 2004, balanca e fitimeve të mbajtur si me 31 Dhjetor 2003 në shumën prej 508,000 mijë Euro është përvetësuar në tërësi me 8 Qershor 2004. Shuma prej 406 mijë Euro u është shpërndarë aksionarëve në formë të aksioneve të reja, dhe pjesa e mbetur në shumën 102 mijë Euro është transferuar në llogarinë e Rezervave të Rrezikut të Përgjithshëm, për të mbuluar rrezikun e përgjithshëm me të cilin është ballafaquar Banka gjatë rrjedhës normale të biznesit.

13. TË HYRAT NGA TARIFAT DHE KOMISIONET

	Me 31 dhjetor 2010	Me 31 dhjetor 2009
Shërbimet bankare	1,037	980
Aktivitetet e huadhënies	575	331
Garancionet	146	252
Totali	1,758	1,563

14. TË HYRAT TJERA OPERATIVE

	Me 31 dhjetor 2010	Me 31 dhjetor 2009
Rigjenerimi nga shlyerja e kredive	251	410
Të hyra tjera	33	75
Totali	284	485

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

15. SHPENZIMET TJERA OPERATIVE

	Me 31 dhjetor 2010	Me 31 dhjetor 2009
Stafi	2,223	2,009
Qiraja	683	570
Zhvlerësimi	555	452
Amortizimi	29	30
Shpenzimet komunale dhe karburantet	167	156
Komunikimi	90	103
Udhëtimi	26	25
Reklamimi dhe marketingu	378	205
Materialet për zyre	47	37
Riparimi dhe mirëmbajtja	90	160
Sigurimi	127	146
Auditimi dhe këshillimi	47	26
Printimi	30	21
Shërbimi i TI-së	92	35
Të tjera	428	142
Totali	5,013	4,117

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

16. TATIMI MBI TË HYRAT

Tatimi mbi fitimin në Kosovë është vlerësuar me prej 10% të të ardhurave të tatueshme. Më poshtë jepet bashkëndimi i tatimit në të ardhura i llogaritur me normën tatimore në fuqi për shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat.

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010	Për fund vitin 31 Dhjetor 2009
Fitimi para tatimit	(612)	749
Tatimi prima facie i llogaritur me 10%	(61)	75
Ndikimi tatimor i shpenzimeve të pa lejueshme për qëllime taksash	21	3
Ndikimi tatimor i shpenzimeve të lejueshme për qëllime taksash	(11)	-
Shpenzimet e tatimit në fitim 10%	-	78
Humbjet e bartura të tatimit	(51)	-

Harmonizimi i tatimi mbi të ardhurat e korporatave (parapaguar) si në datat e bilancit të gjendjes:

	2010	2009
Tatimi mbi të hyrat (parapaguar) / i pagueshëm më 1 Janar	(42)	283
Shpenzimi i tanishëm i tatimi mbi të hyrat	-	78
Tatimi mbi të hyrat i paguar gjatë vitit	(40)	(403)
Tatimi mbi të hyrat (parapaguar) më 31 Dhjetor	(82)	(42)

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

17. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Zotimet dhe kontigjencat përfshijnë garancionet dhe letrat e kreditit të lëshuara për klientët. Balanca e tyre është e përbërë nga:

	2010	2009
Garancionet:		
Të siguruara nga depozitat	277	334
Të siguruara nga kolaterali tjetër	2,147	2,119
Subtotali	2,424	2,453
Letër Kreditë	126	132
Totali	2,550	2,585

Banka lejon garancione për klientët e saj. Këto instrumente bartin me vete rrezik të ngjashëm me ato të kredive të lejuara. Duke u bazuar në vlerësimet e menaxhmentit, nuk do të ketë humbje materiale nga garancionet e mbetura si me 31 Dhjetor 2010.

Zotimet për qiranë operacionale

Banka ka zotime pezull nga kontratat mbi qiranë me afate të përfundimit si më poshtë:

	Me 31 dhjetor 2010	Me 31 dhjetor 2009
Brenda një viti	597	524
Brenda dy deri në pesë vite	1,307	1,544
Totali	1,904	2,068

Çështjet gjyqësore

Kohë pas kohe në rrjedhën e zakonshme të biznesit, janë pranuar ankesa kundër bankës. Me 31 Dhjetor, 2009, Banka nuk kishte ankesa ligjore kundër saj që nuk ishin të vogla si dhe gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit. Në bazë të këshillave të brendshme dhe të jashtme, menaxhmenti është i mendimit se asnjë humbje materiale nuk do të ndodh dhe nuk është bërë asnjë provizionim në këto pasqyra financiare.

18. SHPALOSJET ME PALËT E NDËRLIDHURA

Një palë është e ndërlidhur me një entitet nëse, drejtpërdrejtë apo jo drejtpërdrejtë përmes një apo më shumë ndërmjetësuesve, pala kontrollon, është e kontrolluar nga apo është nën kontrollin e njëjtë me entitetin, pala ka ndonjë interes në entitetin i cili jep influencë domethënëse mbi entitetin, pala ka kontroll të përbashkët mbi entitetin, pala është ortak apo pala është anëtare e menaxhmentit udhëheqës në entitet apo në entitetin amë.

Më poshtë janë balancat me palët e ndërlidhura në fund të vitit:

Lloji i palëve të ndërlidhura:	Bordi i Drejtorëve		Aksionarët kryesor dhe palët e ndërlidhura me të	
	2010	2009	2010	2009
Kreditë e klientëve:				
Kreditë pezull me 1 Janar	823	180	15,796	13,109
Kreditë e lëshuara gjatë vitit	1,782	1,927	17,414	13,057
Kreditë e ripaguara gjatë vitit	(919)	(1,284)	(11,297)	(10,370)
Kreditë e mbetura më 31 Dhjetor	1,686	823	21,913	15,796

Detyrime ndaj klientëve:	Bordi i Drejtorëve		Aksionarët kryesor dhe palët e ndërlidhura me të	
	2010	2009	2010	2009
Depozitat e klientëve me 1 Janar	146	149	32,248	24,155
Shumat e depozituar gjatë vitit	3,493	915	53,732	47,992
Shumën e tërhequr gjatë vitit	(3,167)	(918)	(50,800)	(39,899)
Detyrime ndaj klientëve më 31 Dhjetor	472	146	35,180	32,248

Më poshtë janë transaksionet me palët e lidhura gjatë vitit 2010.

Transaksionet:	Bordi i Drejtorëve		Aksionarët kryesor dhe palët e tjera të ndërlidhura	
	2010	2009	2010	2009
Të hyrat nga interesi	23	23	1,448	1,089
Të hyrat nga tarifat dhe komisioni	13	-	73	34
Shpenzimet e interesit	1	10	56	132

Transaksionet me personelin kyç menaxherial

Totali i shpërblimeve ndaj personelit kyç menaxherial të Bankës është i përfshirë në "shpenzimet e personelit"

	Fund viti 31 Dhjetor 2010	Fund viti 31 Dhjetor 2009
Përfitimet afatshkurtra për punonjësit për BeD	58	72
Përfitimet afatshkurtra për menaxhmentin kyç	129	164
	187	236

19. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT

a) Menaxhimi i rrezikut kapital

Banka menaxhon kapitalin e saj për t'u siguruar për vazhdimësinë e biznesit të saj derisa maksimizon kthimin për aksionarët përmes optimalizimit të balancës së borxheve dhe ekuitetit. Strategjia e përgjithshme e bankës mbetet e pandryshuar që nga viti 2009.

Struktura e ekuitetit të bankës përmban kapitalin e emtuar, rezervën e rrezikut të përgjithshëm dhe fitimin e mbajtur.

Raporti i borxhit

Këshilli për menaxhimin e rrezikut të bankës rishikon strukturën e kapitalit vazhdimisht. Si pjesë e këtij rishikimi, këshilli merr në konsideratë koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur për secilën klasë të kapitalit. Me 31 Dhjetor 2010 banka nuk ka pasur instrumente borxhi.

b) Politikat kryesore kontabël

Detajet e politikave kryesore kontabël dhe metodave të adoptuara, duke përfshirë kriteret e njohjes, bazat e matjes dhe bazat mbi të cilat të hyrat dhe shpenzimet njihen, për secilën klasë të aseteve financiare, detyrimeve financiare dhe instrumenteve të kapitalit janë shpalosur në pikën 3 të pasqyrave financiare.

c) Kategoritë e instrumenteve financiare

Në fund të vitit Banka ka këto instrumente financiare:

Asetet financiare:	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Paraja në dorë dhe ekuivalentët e parasë	25,581	18,757
Balancat me BQK	9,554	14,008
Kreditë për klientët	87,235	63,605
Detyrimet financiare me kosto të amortizimit:	113,175	85,733

19. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

d) Objektivat e menaxhmentit të rrezikut financiar

Funksioni i trezorit të korporatave ofron shërbime për bizneset, koordinon qasjen në tregjet financiare të brendshme dhe të jashtme, monitoron dhe menaxhon rreziqet financiare në lidhje me operacionet e bankës, përmes raporteve të brendshme të rrezikut të cilat e analizojnë ekspozimin ndaj rrezikut në bazë të shkallëve dhe gjerësisë së rrezikut. Këto rreziqe përfshijnë rrezikun e tregut (duke përfshire rrezikun e valutave, rrezikun e normave të kamatës), rrezikun e kreditit dhe rrezikun e likuiditetit.

Përputhja me politikat dhe limitet e ekspozimit është rishikuar nga komisionet e menaxhimit dhe auditorët e brendshëm në mënyrë të vazhdueshme. Banka nuk merret ose tregton instrumente financiare derivative.

e) Rreziku i tregut

Aktiviteti i bankës e ekspozon atë fillimisht me rrezikun financiar në këmbimet valutore dhe normat e interesit. Rreziku i tregut nuk është i koncentruar në mënyrë domethënëse në riskun e valutave apo riskun e normave të interesit, sepse numri më i madh i transaksioneve të bankës janë në valutën lokale dhe normat e interesit janë fikse.

f) Rreziku i valutave të huaja

Banka bënë transaksione në Euro dhe valuta tjera. Banka nuk ka hyrë në ndonjë këmbim derivati të parashikuar apo transaksione rrjedhëse deri më 31 Dhjetor 2010.

Banka i ekspozohet rrezikut valutor përmes transaksioneve në valuta të huaja. Meqë valuta në të cilën Banka i paraqet pasqyrat financiare është Euro, pasqyrat financiare të Bankës ndikohen nga lëvizjet në kursin e këmbimit valutor ndërmjet Euro-s dhe valutave tjera.

Ekspozimet e transaksioneve bankare rrisin fitimet ose humbjet ndaj valutave të huaja që njihen në pasqyrën e të ardhurave. Këto ekspozime përfshijnë pasuritë monetare dhe detyrimet monetare të bankës të cilat nuk janë denominuar në valutën matëse të bankës.

Analiza e ndjeshmërisë së valutave të huaja

Më 31 dhjetor 2010 boshllëku i valutave të huaja neto (të detajuar si në tabelën më poshtë) nuk është i rëndësishëm për pasqyrat financiare si një tërësi, ku menaxhmenti beson se çdo ndryshim në kursin valutor në të ardhmen do të ketë ndikim të parëndësishëm mbi fitimin dhe humbjen në të ardhmen e parashikueshme.

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

Analiza e asetëve dhe detyrimeve monetare më 31 dhjetor, 2010 dhe 2009 nga valutat në të cilën ato ishin të emëruara ishte si vijon:

Asetet	Me 31 Dhjetor, 2010				
	EUR	USD	CHF	GBP	TOTAL
Paraja në dorë dhe në banka	21,278	3,130	1,142	31	25,581
Balancat me BQK	9,554	-	-	-	9,554
Kreditë e dhëna klientëve	87,235	-	-	-	87,235
Pasuritë tjera	1,081	-	-	-	1,081
	119,148	3,130	1,142	31	123,451
Detyrimet					
Depozitat e klientëve	108,889	3,080	1,029	7	113,005
Detyrimet tjera	171	-	-	-	171
	109,060	3,080	1,029	7	113,176
Pozita e valutave të huaja në neto	10,088	50	113	24	10,275

Asetet	Me 31 Dhjetor, 2009				
	EUR	USD	CHF	GBP	TOTALI
Paraja në dorë dhe në banka	15,957	2,350	427	23	18,757
Balancat me BQK-në	14,008	-	-	-	14,008
Kreditë e dhëna klientëve	63,605	-	-	-	63,605
Asetet tjera	998	-	-	-	998
	94,568	2,350	427	23	97,368
Detyrimet					
Depozitat e klientëve	108,889	3,080	1,029	7	113,005
Detyrimet tjera	171	-	-	-	171
	109,060	3,080	1,029	7	113,176
Pozita e valutave të huaja në neto	10,088	50	113	24	10,275

19. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

g) Rreziku nga normat e interesit

Rreziku nga normat e interesit përbëhet nga rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të lëvizë si rezultat i lëvizjeve të normave të interesit në treg dhe rrezikun që afati i maturimit të pasurive që sjellin interes do të ndryshojë nga afati i maturimit të detyrimeve që përdoren për të financuar këto pasuri. Koha gjatë të cilës norma e interesit për një instrument financiar është e fiksuar kushtëzon se në çfarë mase banka do të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut të normave të kamatës. Pasuritë dhe depozitat e klientëve të bankës mbartin norma fikse të interesit. Normat e interesit të aplikueshme në pasuritë dhe detyrimet financiare janë të shpalosura në shënimet relevante në këto pasqyra financiare.

Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të fluktuimit të normave të interesit në atë masë që interesi nga pasuritë dhe detyrimet maturon apo ricakton një çmim në kohë të ndryshme apo në shuma të ndryshme. Banka tenton që të zbus këtë rrezik duke monitoruar datat e ricaktimit të çmimit të pasurive apo detyrimeve. Veç kësaj, efekti aktual do të varet nga një varg faktorësh të tjerë, duke përfshirë nivelin ku ripagimet janë bërë më herët apo më vonë nga data e kontraktuar dhe ndërrimet në ndjeshmërinë e normës së interesit gjatë ricaktimit të çmimit dhe ndërmjet valutave.

Analiza e normës së interesit është detajuar më poshtë

(a) Informata për mesataren e te hyrave

Te hyrat mesatare të kategorive më të mëdha të mjeteve dhe detyrimeve të Bankës me 31 Dhjetor 2010 dhe 2009 janë si vijon:

Norma mesatare e interesit	EUR		USD		CHF	
	2010	2009	2010	2009	2010	2009
Asetet :	%	%	%	%	%	%
Paraja në dorë dhe në banka	0.23	0.5	0.12	0.10	-	-
Balancat e kufizuara me BQK-në	0.10	0.28	-	-	-	-
Kreditë dhe avancat për klientët	11.65	11.44	-	-	-	-
Detyrimet:						
Depozitat nga klientët	3.94	3.85	1.83	1.14	0.21	0.19

19. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

g) Rreziku nga normat e interesit (vazhdim)

(b) Analiza e ricaktimit të normave të interesit

Tabela e mëposhtme paraqet datat e ricaktimit të normave të interesit për pasuritë dhe detyrimet monetare të Bankës. Norma fikse të pasurive dhe detyrimeve janë raportuar duke u bazuar në planin e datave të ripagimit të principalit.

Me 31 Dhjetor 2010	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	mbi 1 vit	Totali
Asetet:						
Paraja në dorë dhe në bankat e saj	25,219	-	-	-	362	25,581
Interesat fituese	18,152	-	-	-	362	18,514
Jo interes fituese	7,067	-	-	-	-	7,067
Balancat me BQK	-	-	-	-	9,554	9,554
Interes fituese	-	-	-	-	9,554	9,554
Kreditë e dhëna klientëve	5,403	1,765	2,591	23,262	54,214	87,235
Interes fituese	5,403	1,765	2,591	23,262	54,214	87,235
Parapagimet e tatimit në të hyra	-	-	82	-	-	82
Jo interes fituese	-	-	82	-	-	82
Asetet tjera	33	-	-	597	451	1,081
Interes fituese	-	-	-	-	451	451
Jo interes fituese	33	-	-	597	-	630
Totali	30,655	1,765	2,673	23,859	64,581	123,533
Detyrimet:						
Depozitat nga klientët	33,637	10,775	7,852	34,565	26,176	113,005
Interes fituese	18,293	10,775	7,852	34,565	26,176	97,661
Jo interes fituese	15,344	-	-	-	-	15,344
Detyrimet tjera dhe tatimi i pagueshëm	171	-	-	-	-	171
Jo interes fituese	171	-	-	-	-	171
Totali i detyrimeve interes fituese	33,808	10,775	7,852	34,565	26,176	113,176
Ndryshimi	(3,153)	(9,010)	(5,179)	(10,706)	38,405	10,357
Ndryshimi kumulativ	(3,153)	(12,163)	(17,342)	(28,048)	10,357	-

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

19. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

g) Rreziku nga normat e interesit (vazhdim)

(b) Analiza e ricaktimit të normave të interesit (vazhdim)

Me 31 Dhjetor 2009	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	mbi 1 vit	Totali
Asetet:						
Paraja në dorë dhe banka	18,424	-	-	-	333	18,757
Interes fituese	11,261	-	-	-	333	11,594
Jo interes fituese	7,163	-	-	-	-	7,163
Balancat kufizuese me BQ-në	-	-	-	-	14,008	14,008
Interes fituese	-	-	-	-	14,008	14,008
Kreditë ndaj klientëve	4,561	3,629	2,314	11,203	41,898	63,605
Interes fituese	4,561	3,629	2,314	11,203	41,898	63,605
Parapagimet e tatimit në të hyra	-	-	42	-	-	42
Jo interes fituese	-	-	42	-	-	42
Asetet tjera	47	-	-	346	563	956
Interes fituese	-	-	-	-	563	563
Jo interes fituese	47	-	-	346	-	393
Totali	23,032	3,629	2,356	11,549	56,802	97,368
Detyrimet:						
Depozitat nga klientët	27,564	3,455	11,519	22,530	20,490	85,558
Interes fituese	14,637	3,445	11,516	22,311	18,979	70,888
Jo interes fituese	12,927	10	3	219	1,511	14,670
Detyrimet tjera dhe tatimi i pagueshëm	175	-	-	-	-	175
Jo interes fituese	175	-	-	-	-	175
Totali	27,739	3,455	11,519	22,530	20,490	85,733
Ndryshimi	(4,707)	174	(9,163)	(10,981)	36,312	11,635
Ndryshimi kumulativ	(4,707)	(4,533)	13,696	(24,677)	11,635	-

19. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

h) Rreziku kreditor

Banka i ekspozohet këtij rreziku përmes aktiviteteve të dhënies së kredive dhe në rastet kur ajo vepron si ndërmjetësuese në interes të klientëve ose të palëve të treta ose kur lëshon garancione. Në këtë aspekt, rreziku kreditor për bankën buron nga mundësia që palët e ndryshme mund të vonohen në kryerjen e obligimeve kontraktuale. Menaxhimi i rrezikut kreditor nga ekspozimi ndaj huamarrësve kryhet përmes analizave të rregullta të bonitetit të huadhënësve. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor pjesërisht menaxhohet edhe me anë të marrjes së kolateralit dhe garantuesve.

Ekspozimi parësor ndaj rrezikut kreditor del nga kreditë dhe avancat e dhëna për klientët e saj. Shuma e ekspozimit në këtë kontekst përfaqësohet nga vlera bartëse e mjeteve në bilancin e gjendjes. Veç kësaj, banka është e ekspozuar edhe ndaj rrezikut kreditor jashtë-bilancor përmes dhënies së garancioneve. Koncentrimi i rrezikut kreditor (si atij bilancor dhe jashtë-bilancor) i cili lind nga instrumentet financiare, ekziston për palët tjera kur ato kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që mund të bëjnë që aftësia e tyre për të paguar obligimet kontraktuale të ndikohet ngjashëm nga ndryshimet e kushteve ekonomike apo kushteve të tjera. Koncentrimet më të mëdha të rrezikut kreditor rrjedhin nga lloji i klientit në lidhje me kreditë dhe avancat e lëshuara nga banka apo nga garancionet e lëshuara.

Vlera bartëse e pasurive financiare e regjistruar në pasqyrat financiare, që është neto e humbjeve nga humbja e vlerës, përfaqëson maksimumin e ekspozimit të bankës ndaj rrezikut kreditor, pa marrë parasysh këtu vlerën e kolateralit të marrë. Ju lutem shikoni notën 6 për më shumë rreth ekspozimit të bankës në lidhje me sektorët e ndryshëm.

Në fund të vitit, kreditë janë të siguruar si vijon:

	2010	%	2009	%
Hipotekat	15,960	18	12,882	20
Kolateral në para	14,074	15	13,768	21
Pengu	34,449	38	17,778	27
Mikse (Hipoteka dhe pengu)	25,253	28	19,754	31
Garantues personal	498	1	530	1
Totali	90,234	100	64,712	100

19. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

l) Rreziku i likuiditetit

Risku i likuiditetit paraqitet në financimin general të aktiviteteve të Bankës dhe në pozicionet e menaxhimit. Risku i likuiditetit përfshinë të dyja, riskun lidhur me pamundësinë e financimit të aseteve dhe tarifat si dhe rrezikun e pamundësisë së likuidimit të asetit me çmim të arsyeshëm dhe në kohën e duhur për arritjen e përmbushjes së obligimeve. Banka monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhoj obligimet e saj.

Fondet gjenerohen duke përdorur një varg të instrumenteve duke përfshirë depozitat, huamarrjet dhe kapitalin aksionar. Kjo mundëson fleksibilitetin e financimit, limitet e varshmërisë së mbështetjes në ndonjë burim dhe në përgjithësi zvogëlon kostot e financimit. Banka mundohet që të mbajë balancën në mes të vazhdimit të financimit dhe fleksibilitetin duke përdorur detyrime me afate të ndryshme të maturimit.

Banka në mënyrë të vazhdueshme monitoron riskun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në financim të cilat kërkohen për arritjen e qëllimeve dhe targeteve të përcaktuara në strategjinë e përgjithshme të Bankës. Për më tepër, banka mban asete likuide si pjesë të menaxhimit të strategjisë së riskut të likuiditetit.

Tabela e mëposhtme tregon analiza të aseteve financiare dhe detyrimeve të Bankës në grupe relevante të maturimit, në bazë të periudhës së pagimit.

Me 31 Dhjetor 2010	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Asetet						
Paraja në dorë dhe në banka	25,219	-	-	-	362	25,581
Balancat me BQK-ne	-	-	-	-	9,554	9,554
Kreditë për klientët	5,403	1,765	2,591	23,262	54,214	87,235
Asetet tjera	33	-	82	653	313	1,081
Totali	30,655	1,765	2,673	23,915	64,443	123,451
Detyrimet						
Depozitat nga klientët	33,637	10,775	7,852	34,565	26,176	113,005
Detyrimet tjera dhe tat. i pagueshëm	171	-	-	-	-	171
Totali	33,808	10,775	7,852	34,565	26,176	113,176
Ndryshimi i lik. 31 Dhjetor 2010	(3,153)	(9,010)	(5,179)	(10,650)	38,267	10,275
Ndryshimi kumulativ 31 Dhjetor 2010	(3,153)	(12,163)	(17,342)	(27,992)	10,275	-

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

19. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

l) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Me 31 Dhjetor 2009	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	Më shumë se një vit	Totali
Asetet						
Paraja dhe ekuivalentet e saj	18,424	-	-	-	333	18,757
Balancat me BQK	-	-	-	-	14,008	14,008
Kreditë për klientëve	4,561	3,629	2,314	11,203	41,898	63,605
Asetet tjera	47	-	42	346	563	998
Totali	23,032	3,629	2,356	11,549	56,802	97,368
Detyrimet						
Depozitat e klientëve	27,564	3,455	11,519	22,530	20,490	85,558
Detyrimet tjera dhe tat. l parapag.	175	-	-	-	-	175
Totali	27,739	3,455	11,519	22,530	20,490	85,733
Ndryshimi i lik. 31Dhjetor 2009	(4,707)	174	(9,163)	(10,981)	36,312	11,635
Ndryshimi kumulativ 31Dhjetor 2009	(4,707)	(4,533)	(13,696)	(24,677)	11,635	-

j) Vlera e tregut e instrumenteve financiare

SNRF përcakton një hierarki të ashtu-quajtur e përcaktimit vlerës së drejtë që reflekton besueshmërinë relative të mënyrave të ndryshme për të marrë një vlerë të tregut:

(a) Tregu Aktiv: çmimi i kuotuar (Niveli 1)

Vëzhgoni çmimet e cituara për instrumente identike financiare në tregjet aktive.

(b) Teknika e vlerësimit duke përdorur inpute të mbikëqyrura (Niveli 2)

Vëzhgoni çmimet e cituara për instrumente të ngjashme në tregjet aktive apo çmimet e cituara për instrumente identike ose të ngjashme në tregjet joaktive apo modelet e përdorimit të vlerësimit ku të gjithë inputet e rëndësishme janë të dukshëm.

(c) Teknika e vlerësimit me inpute të rëndësishme jo të dukshme (Niveli 3)

Përdorin modelet e vlerësimit ku një ose më shumë inpute të rëndësishme nuk janë të dukshëm.

Vetëm nëse mënyra e parë më e mirë e caktimit të vlerës së drejtë nuk është në dispozicion mund të përdoret metoda e ardhshme mund të zbatohet. Që kur çmimet e cituara nuk janë të disponueshme në tregun e Kosovës, Banka ka përdorur teknikën Niveli 2, duke përdorur çmimet e produkteve të ngjashme në treg.

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekën ndryshe)

19. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

I) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Më poshtë është vlera e tregut të aseteve dhe detyrimeve financiare si në fund të vitit.

Asetet	Me 31 Dhjetor 2010		Me 31 Dhjetor 2009	
	Shuma bartëse	Vlera e tregut	Shuma bartëse	Vlera e tregut
Paraja dhe balancat bankare	25,581	25,581	18,757	18,757
Balancat me BQK	9,554	9,554	14,008	14,008
Kreditë për klientëve	87,235	87,235	63,605	63,605
Asetet tjera	1,081	1,081	956	956
Detyrimet	113,005	113,005	85,558	85,558
Llogaritë e pagueshme	171	171	175	175

20. NGJARJET E MËPASME

Pas datës së pasqyrës së bilancit nuk ka pasur ngjarje të rëndësishme ose kusht, të cilat kërkojnë rregullim ose shpalosje në këto pasqyra financiare.

8. Adresat dhe kontaktet

DEGA PRISHTINË

ZYRA QENDRORE - PRISHTINË
Rr. Migjeni nr.1
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 22 53 53
Fax: +381 (0) 38 22 54 54
info@bekonomike.com

Nëndega
Prishtinë
Rr. Bulevardi Nëna Terezë p.n

Nëndega
Prishtinë
Bregu i Diellit
Rr. Gazmend Zajmi nr.48

Nëndega
Prishtinë
Ulpianë
Rr. Bulevardi i Dëshmorëve nr.72

Nëndega
Prishtinë
Tregu me shumicë
Zona Industriale

Nëndega
Padujevë
Rr. Skënderbeu p.n
Tel: +381 (0) 38 570 710

Zyra Bankare
Prishtinë
Objekti - Kryqi i Kuq
Rr. Fazli Grajqevci p.n

Zyra Bankare
Prishtinë
Llapnasellë

Zyra Bankare
Prishtinë
Hajvali

Zyra Bankare
Drenas
Kuvendi Komunal
Rr. Xhevë e Fehmi Lladrovci

Zyra Bankare
Lipjan
Agro Trade
Rr. Magjistrale Prishtinë – Ferizaj km.7

Nëndega
Fushë Kosovë,
Nënë Tereza, Blloku 2

Nëndega
Drenas
Rr" Xhevë e Fehmi Lladrovci";Lam 7,
lokali nr.2

DEGA GJAKOVË

Rr. Nëna Terezë p.n
50000 Gjakovë, Kosovë
Tel: +381 (0) 390 322 222,
Fax: +381 (0) 390 325 858,
gjakova@bekonomike.com

Nëndega
Rahovec
Rr. Sylejman Vokshi nr.502
Tel: +381 (0) 29 277 902
Fax: +381 (0) 29 277 902

Zyra Bankare
Gjakovë
Rr. Skenderbeu p.n

Zyra Bankare
Gjakovë
Kuvendi Komunal
Rr. Nëna Terezë p.n

Zyra Bankare
Rahovec
Kuvendi Komunal
Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut nr.485

Zyra Bankare
Rahovec
Kontollimi Teknik
Rr. Sadedin Hajda p.n

DEGA PEJË
Rr. Eliot Engel nr.33
30000 Pejë, Kosovë
Tel: +381 (0) 39 434 815
Fax: +381 (0) 39 434 815
peja@bekonomike.com

Nëndega
Istog
Rr. Skenderbeu p.n
Tel: +381 (0) 39 451 339
Fax: +381 (0) 39 451 339

Nëndega
Junik
Rr. Hoxhaj p.n
Tel: +381 (0) 390 370 001

Nëndega
Klinë
Rr. Abedin Rexha p.n
Tel: +381 (0) 39 470 240

Zyra Bankare
Pejë
Rr. Eliot Engel p.n

Zyra Bankare
Pejë
Terminali Doganor
Rr. Nexhdet Basha p.n

Zyra bankare
Pejë
Rr.Mbretëresha Teuta,p.nr.

Nëndega
Deçan
Rr."Sali Çeku", Zona e I-rë

DEGA PRIZREN
Rr. Rrasat e Kosharës nr.16
20000 Prizren, Kosovë
Tel: +381 (0) 29 242 234
Fax: +381 (0) 29 241 940
prizreni@bekonomike.com

Nëndega
Prizren
Bazhdarhane
Rr. Adem Jashari nr.91

Nëndega
Suharekë
Rr. Brigada 123 p.n

Zyra Bankare
Prizren
Pranë Gjykatës
Rr. Ibrahim Lutfiu nr.4

Zyra bankare
Vërmicë
Terminali Doganor

Zyra Bankare
Prizren
Në objektin e komunës

DEGA MITROVICË
Rr. Mbretresha Teutë p.n
40000 Mitrovicë, Kosovë
Tel: +381 (0) 28 532 700
Fax: +381 (0) 28 534 700
mitrovica@bekonomike.com

Nëndega
Vushtrri
Rr. Wesley Clark p.n
Tel: +381 (0) 28 573 701

Nëndega
Skenderaj
Lagaj nr.1, Rr"Xhevë e Fehmi
Lladrovci

Zyra Bankare
Mitrovicë
Terminali Doganor
Rr. Parku Industrial p.n

DEGA GJILAN

Rr. Adem Jashari nr.215
60000 Gjilan , Kosovë
Tel: +381 (0) 280 320 055
Fax: +381 (0) 280 320 609
gjilani@bekonomike.com

Nëndega
Gjilan
Rr. Bulevardi i Pavarësisë p.n
Tel: +381 (0) 280 320 273
Fax: +381 (0) 280 323 693

Nëndega
Kamenicë
Rr. Skenderbeu p.n
Tel: +381 (0) 280 370 188

Zyra Bankare
Dheu i bardhë
Terminali Doganor
Rr. Bujanovcit

Nëndega
Viti
Rr."Njazi Azemi", p.nr.

DEGA FERIZAJ
Rr. Dëshmorët e Kombit nr.204
70000 Ferizaj, Kosovë
Tel: +381 (0) 290 321 260
Fax: +381 (0) 290 322 052
ferizaji@bekonomike.com

Nëndega
Shtërpcë
Rr. Kryesore, p.nr.

Zyra Bankare
Hani i Elezit
Terminali Doganor